

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE



PUNIM DIPLOME MASTER

**Tema: “*Delikuenca e të miturve në rrethin e Gjykatës Themelore të Gjilanit nga viti
2008-2018*”**

Profesor: Ismajl Zejneli

Kandidati: Fat Mustafa

TETOVË, 2020

PËRMBAJTJA

- Hyrje

Kapitulli I

1. Kuptimi i delikuentes së të miturve.....
2. Aspekte kriminologjike të delikuentes së të miturve.....
3. Aspekte sociologjike të delikuentes së të miturve.....
4. Trajtime komperativ të delikuentes së të miturve.....
 - 4.1. Aspekte krahasimore me Republikën e Shqipërisë.....
 - 4.2. Aspekte krahasimore me Republikën e Maqedonise së Veriut.....

Kapitulli II

1. Trajtimi juridiko penal i delikuentes së të miturve.....
2. Parimet bazë që u referohet personave të mitur.....
 - 2.1. Parimi i ligjshmërisë.....
 - 2.2. Parimi i humanizimit.....
 - 2.3. Parimi i pafajsisë.....
 - 2.4. Parimi i interesit më të lartë të femijës.....
 - 2.5. Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi.....
3. Konventat ndërkombëtare për trajtimin e të miturve.....

Kapitulli III

1. Profili i delikuentëve të mitur kryerësve të veprave penale
 - 1.1. Moshë e të miturve
 - 1.2. Gjinia e të miturve
2. Gjendja ekonomike
3. Përkatësia nacionale

Kapitulli IV

1. Parandalimi i kryerjes së veprave penale nga ana e të miturve.....
2. Roli i gjykatës në parandalimin e delikuentes së të miturve.....
3. Roli i policisë në parandalimin e delikuentes së të miturve.....
4. Roli i entit social në parandalimin e delikuentes së të miturve.....
5. Roli i mas-mediave në parandalimin e delikuentes së të miturve.....
6. Të dhënat hulumtuese mbi punimin.....

Hyrja

Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar. Delikuenca gjithmonë ka ekzistuar dhe është shfaqur ku më pak e ku më shumë, varësisht nga ndryshimet në shoqëri dhe në mjedisin ku kanë jetuar të rinjtë. Kjo lloj sjellje (delikumente) e të rinjve nuk paraqitet aty për aty, por ajo fillon më herët, sjellja asocial fillon me nga mosha 11-14 vjeç. Sjelljet asociale të fëmijëve në këtë moshë janë të shumta dhe të ndryshme. Mënyra e shfaqjes së sjelljeve asocial janë fyerje dhe sharje, rrahje, mosbindje, vjedhje, ikje nga shtëpia, ikje nga shkolla etj. Në qoftë se në këtë moshë nuk merren masa të duhura për mënjanimin e tyre, ato sjellje kanë rritje të vazhdueshme dhe dalngadalë do të merr epitetin si “fëmijë delikuent”. Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar.

Kriminaliteti i të miturve në Kosovë në teorinë penale juridike, ndryshe është i njohur si delikuencë e të miturve. Legjislacioni penal i Kosovës, çështjen e delikuencës së të miturve e ka rregulluar nëpërmjet dispozitave të posaçme dhe specifike në Kodin e Drejtësisë për të Mitur në korrik të vitit 2010 i cili përmban dispozitat materiale dhe formale të trajtimit penal juridik të tyre. Me nocionin kryes i veprës penale nënkuptojmë kryesit e mitur të veprave penale qofshin ata si kryes, bashkë kryes, nxitës apo ndihmës. Kryes i moshës së mitur është personi i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka pasur 14 vite të plota por nuk i ka mbushur 18 vite.

Veprat penale të kryera nga të mirurit cdo janë në rritje. Të dhënat statistikore japin se të miturit kryejn krime të ndryshme nga vjedhjet deri tek vrasjet mizore, të miturit kryejn këeto vepra penale nga disa faktorë të cilët do ti trajtojmë ne punimin shkencorë siç janë Faktorët ekonomik, politik shoqërorë, mikrogruporë dhe faktorëve sociopatologjik. Gjithashtu të miturit edhe keqpërdoren dhe nxiten nga personat e moshës madhore për të kryer vepra penale.

Numri jashtëzakonisht i madhë i veprave penale të kryera nga të miturit dhe shqiptimi i sanksioneve ndaj tyre, na shtynë të bejmë analizë të posacme per delikencen e të miturve ne rethin e Gjilanit qe ne fund te ketij punimi te dimi se sa vepra penal kryhet gjate nje periudhe te caktuar kohere ng ate miturit dhe si qellim kryesore ne kete punim ti kemi masat preventive per te miturit e me pas ato represive.

KAPITULLI - I

1. Kuptimi i delikuencës së të miturve

Delikuenca e të miturve gjithnjë e më tepër po bëhet problem shqetësues në shoqëri. Nga studimet e shumta na tregojnë se sjelljet delinkuente janë shumë më të përhapura sot, se në të kaluarën.

Delikuencë (Devijim) rrjedh nga fjala latine “*deliquare*” që ka një kuptim shumë të gjerë, me këtë term kuptojmë përgjithësisht shprehjet, sjelljet dhe veprimet e përsëritura të të miturve që bien ndesh me moralin, zakonet dhe ligjet e mjedisit ku jetojnë. Pra delikuent quhet ai që ka sjellje të përsëritura devijuese, që bën vepra kriminale, duke shkelur kështu normat ligjore në fuqi.¹

Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar. Delikuenca gjithmonë ka ekzistuar dhe është shfaqur ku më pak e ku më shumë, varësisht nga ndryshimet në shoqëri dhe në mjedisin ku kanë jetuar të rinjtë. Kjo lloj sjellje (delikuate) e të rinjve nuk paraqitet aty për aty, por ajo fillon më herët, sjellja asocial fillon me nga mosha 11-14 vjeç. Sjelljet asociale të fëmijëve në këtë moshë janë të shumta dhe të ndryshme. Mënyra e shfaqjes së sjelljeve asocial janë fyerje dhe sharje, rrahje, mosbindje, vjedhje, ikje nga shtëpia, ikje nga shkolla etj.²

Në qoftë se në këtë moshë nuk merren masa të duhura për menjanimin e tyre, ato sjellje kanë rritje të vazhdueshme dhe dalngadalë do të merr epitetin si “fëmijë delikuent”. Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar.

Tranzicioni shoqëror në Republikën e Kosovës karakterizohet nga ndryshime të thella dhe intensive shoqërore, të cilat depërtuan në të gjitha sferat e jetën njerëzore duke marrë parasysh këtu edhe sferën e sistemit të vlerave. Kjo lloj anomie, e cila në fillim të tranzicionit shoqëror sundonte gati në të gjitha sferat, mundësoi, përveç të tjerash, edhe rritjen e nivelit të kriminalitetit dhe të dukurive të tjera socio-patologjike.

Kjo situatë u reflektua dukshëm edhe në rritjen e aktiviteteve devijante të grupmoshës së re 14-18 vjeç, të tilla si: narkomania, alkoolizmi, vjedhja, vrasjet e ndryshme, etj.

Sipas policisë së Kosovës, delikuenca e të miturve është një dukuri, e cila manifestohet me mosrespektimin e normave morale dhe juridike

¹ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 19

² (Po aty)

Kriminaliteti i të miturve në Kosovë në teorinë penale juridike, ndryshe është i njohur si delikuenca e të miturve. Legjislacioni penal i Kosovës, çështjen e delikuencës së të miturve e ka rregulluar nëpërmjet dispozitave të posaçme dhe specifike në Kodin e Drejtësisë për të Mitur në korrik të vitit 2010 i cili përmban dispozitat materiale dhe formale të trajtimit penal juridik të tyre. Me nocionin kryes i veprës penale nënkuptojmë kryesit e mitur të veprave penale qofshin ata si kryes, bashkë kryes, nxitës apo ndihmës. Kryes i moshës së mitur është personi i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka pasur 14 vite të plota por nuk i ka mbushur 18 vite.³

Delinkuenca e të miturve përfshin delinkuencën që kryhet nga individët prej fillimit të viteve kur adoleshentët mund të marrin përgjegjësi penale, përtej viteve kur procesohet në kuadër të legjislacionit për të mitur e deri atëherë kur trajtohet me ligj dhe në gjykatën për të rritur.

Në shumicën e vendeve kjo periudhë sillet prej 14 deri 18 vjeç edhe pse në disa vende kufiri i poshtëm i rritjes shtyhet deri në 10 vjet, ndërsa i sipërmi deri në 21 vjet. Pra, nga sa më sipër, delikuenca e të miturve dhe të rinjve është një status që përcaktohet nga gjykata mbi bazën e legjislacioni vendas, mbështetur në provat dhe të dhënat e grumbulluara.⁴

Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur të Republikës së Kosovës, kemi këtë përkufizim sipas grup moshës:

I mitur - është personi ndërmjet moshës katërmëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.

I mitur i ri - personi ndërmjet moshës katërmëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet

I mitur i rritur - personin ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.

Madhor i ri - personi ndërmjet moshës tetëmbëdhjetë (18) dhe njëzetënjë (21) vjet.⁵

Nocioni i mitur

Termi “i mitur” filloi të përdoret në SHBA kur shtetet federale miratuan ligjet që përcaktojnë moshën ligjore për moshën madhore. Termi “i mitur” i referohet çdo personi nën moshën ligjore të moshës madhore (moshës kronologjike në të cilën personi nuk konsiderohet më si i mitur dhe prej të cilës fillon jeta e tij si i rritur - në pjesën më të madhe të shteteve është mosha 18 vjeç).⁶

Prandaj ky koncept përmban një diapazon më të gjerë të moshës sesa adoleshenca e cila fillon me fillimin e pubertetit.

Në këtë studim, koncepti “i mitur” mbështetet në kuptimin që i jep Konventa e të Drejtave të Fëmijës, sipas së cilës “i mitur” është personi që nuk ka mbushur ende moshën

³ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 45

⁴ Kodi Nr. 06/L-006 I Drejtësisë për të Mitur, 2018

⁵ Kodi Nr. 06/L-006 I Drejtësisë për të Mitur, 2018, Neni 3

⁶ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 21

tetëmbëdhjetë vjeç . Periudha e miturisë e cila përkon në një pjesë të madhe të saj edhe me adoleshencën (por kjo e fundit mund të zgjasë më shumë), përbën një etapë delikate në jetën e një personi, plot ankth, duke vënë në provë subjektin në marrëdhëniet e tij ndërpersonale e sociale. Termat *i mitur* dhe *adoleshent* në këtë punim kanë të njëjtin kuptim.⁷

Nocioni Delikuencë

Termi **Delikuencë** (Devijim) rrjedh nga fjala latine “*deliquare*” që ka një kuptim shumë të gjerë, me këtë term kuptojmë përgjithësisht shprehjet, sjelljet dhe veprimet e përsëritura të të miturve që bien ndesh me moralin, zakonet dhe ligjet e mjedisit ku jetojnë. Shikuar historikisht delikuenca e të miturve është e vjetër sa edhe vetë njeriu dhe shoqëria. Pra delikuent quhet ai që ka sjellje të përsëritura devijuese, që bën vepra kriminale, duke shkelur kështu normat ligjore në fuqi. Kjo lloj sjellje (delikuate) e të rinjve nuk paraqitet aty për aty, por ajo fillon më herët të shfaqet por në mënyrë më të lehtë por sjellja asocial fillon me nga mosha e pubertetit 11-14 vjeç.⁸

Delinkuenca e të miturve përfshin delinkuencën që kryhet nga individët prej fillimit të viteve kur adoleshentët mund të marrin përgjegjësi penale, përtej viteve kur procesohet në kuadër të legjislacionit për të mitur e deri atëherë kur trajtohet me ligj dhe në gjykatën për të rritur. Në shumicën e vendeve kjo periudhë sillet prej 14 deri 18 vjeç edhe pse në disa vende kufiri i poshtëm i rritjes shtyhet deri në 10 vjet, ndërsa i sipërmi deri në 21 vjet. Pra, nga sa më sipër, delikuenca e të miturve dhe të rinjve është një status që përcaktohet nga gjykata mbi bazën e legjislacioni vendas, mbështetur në provat dhe të dhënat e grumbulluara.

Me përcaktimin e kufirit më të lartë dhe më të ulët të moshës bëhen edhe ndarjet e të miturve nga popullatat e tjera, përkatësisht bëhet dallimi i delinkuentit të mitur nga delinkuenti fëmijë apo i rritur.⁹

Përkundër botëkuptimeve të përmendura, ka mendime se me kuptimin sjellje delikte të të rinjve të nënkuptohet sjellja e papërshtatshme, përkatësisht kundër shoqërore e të rinjve, madje qoftë ato forma të sjelljeve, të cilat me ligjet pozitive janë përcaktuar si vepra penale dhe kundërvajtje, qoftë edhe shumë delikte edhe sjellje të tjera, të cilat sipas karakterit të tyre imponojnë zbatimin e masave dhe të aksioneve sociale jashtë-penale, edukuese e të tjera. Me fjalë të tjera, delikuencën e të rinjve e kuptojmë si shprehje e tërësishme e të gjitha sjelljeve të rinjve që nuk janë në pajtim me normat e shkruara dhe të pashkruara të sjelljeve shoqërore

⁷ Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, 1989

⁸ L. Veseli, Kriminialistika e Delikuences së të Miturve, faqe 3

⁹ (Po aty)

(juridike e morale). Kjo praktikisht do të thotë se me fjalën sjellje delikte e të rinjve nënkuptojmë jo vetëm me legjislacionin penal të veprimtarisë së paraparë (si kriminalitet), por, për shembull, edhe papunësinë, ikjen nga shtëpia, ikjen nga shkolla, bredhjen, të fjeturit nëpër skuta, përdorimin e alkoolit, sjelljet e pahijshme në rrugë dhe në vendet e tjera publike, si dhe shumë forma të tjera të sjelljeve të ngjashme të cilat shoqëria si tërësi nuk i lejonë.

2. Aspektet kriminologjike të delikuencës së të miturve

Trajtimi kriminologjik - Në kriminologjinë moderne kohëve të fundit delikuenca e të miturve zë gjithnjë e më tepër vend me rendësi dhe mund të thuhet se ajo ditë më ditë paraqet temë të kohës. Problemi parësor i kriminologjisë si shkencë është të gjejë shkaqet e sjelljeve kriminale të të miturve, pra të japë shpjegime etiologjike të delikuencës së të miturve si fenomen i posaçëm.¹⁰

Që të arrije këtë qëllim kriminologjia si shkencë duhet ti analizojë më thellë proceset shoqërore në njërën anë dhe personalitetin e delinkuentit në anën tjetër. Gjatë shqyrtimit të kësaj teme shpesh kemi hasur në shëni- me që tregojnë jo vetëm për rritjen e këtij lloji të kriminalitetit por edhe për paraqitjen e formave të reja të delikuencës së të miturve.

Sipas studimeve të shumta empirike faktorët që ndikojnë më së shumti në paraqitjen e delikuencës janë të shumta si p.sh.: faktorët ekonomikë, socialë, kulturorë etj.¹¹

Nocioni: kriminaliteti i të rinjve përdoret për të theksuar aktivitetin kriminal të të gjithë të miturve pa marrë parasysh moshën. Për arsye se ekziston një bindje se e gjithë popullata e re pa marrë parasysh se në çfarë faze gjendet në pikëpamje bio-psikike dhe socio-kulturore ende nuk është formuar dhe se për këtë arsye ende është e nevojshme një qasje dhe trajtim i veçantë. Ky kuptim pak më i gjerë i delikuencës së të miturve më tepër gjen aplikim në trajtimet dhe studimet kriminologjike dhe sociologjike e më pak në ato juridiko-penale sepse sipas konceptit juridiko-penal kjo çështje është rregulluar në mënyrë të saktë dhe konkrete më anë të dispozitave penale ku janë përcaktuar moshat dhe kategoritë e caktuara.

Për dukurinë e krimit, format shkaqet, pasojat dhe parandalimin e tij, në literaturën shqiptare ka të dhëna të pakta dhe hulumtime jo të mjaftueshme ose fare gjithmonë në krahasim me shtetet tjera.¹²

Lidhur me krimin në hapsirën shqiptare është shkruar në periudha të ndryshme, që nga rilindasit shqiptarë e deri në ditët e sotme, shkrimet kryesisht janë bërë në veprat e tyre, në

¹⁰ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 46

¹¹ (Po aty)

¹² (Po aty)

poezi, prozë, romane, dramë dhe në gazetat e ndryshme të kohës.

Ata në mënyrë shumë kritike kanë analizuar dhe shtjelluar çështjet lidhur me krimin dhe pasojat e tyre në shoqërinë shqiptare. Në këto krijime kanë gjykuar për disa vese dhe dukuri negative dhe kriminale që kanë penguar zhvillimin kombëtar.

Dukurit kryesore të cilët janë marrë autorët e ndryshme janë me kryesisht me gjakmarrjen, hakmarrjen, grabitje, etj.¹³

3. Aspektet sociologjike të delikuencës së të miturve

Përmbajtja e sjelljeve devijante ndryshon historikisht që nga e kaluara e deri sot. Në çdo tip të shoqërisë kemi forma të ndryshme të manifestimit të sjelljeve devijante, mënyra të ndryshme të kryerjes së këtyre veprave si dhe reagim të ndryshëm shoqëror. E gjithë kjo kërkon qasje adekuate shkencore për t'u sqaruar dhe hulumtuar.

Në këtë drejtim në sociologjinë e sjelljeve devijante, patologjinë sociale, në kriminologji e shkenca tjera ekzistojnë disa teori shkencore të cilat bëjnë përpjekje ta ndriçojnë shkakun e këtyre dukurive devijante. Është e pamundur që të diskutohet, të hulumtohen dhe të identifikohen shkaqet e sjelljeve devijante në shoqëri e të mos merren parasysh arritjet dhe rezultatet e këtyre teorive shkencore.¹⁴

Teoritë më kryesore në lidhje me dukuritë devijante në shoqëri, janë teoritë antropologjike dhe biologjike, teoritë psikologjike dhe teoritë sociologjike të cilat kanë edhe nënteoritë e tyre, që ndihmojnë zhvillimin e hulumtimeve në lidhje me dukurinë e delinkuencës së të miturve.

Teoritë dhe pikëpamjet sociologjike mbi sjelljet devijante dhe delikuate nuk janë unike. Sipas mënyrës se si i sqarojnë dukuritë sociopatologjike, ato dallohen dhe janë të ndryshme si në aspektin kohor, ashtu edhe në aspektin paradigmatic. Shkaqet kryesore që mundësuan paraqitjen e këtyre pikëpamjeve mbi dukuritë sociopatologjike janë të ndryshme p.sh.: 1. Lëvizjet migruese, të cilat krijojnë realitetin e shoqërive (qofshin ato njëetnike apo shumëetnike) që përbëhen nga më shumë kultura, grupe shoqërore dhe religjione të ndryshme. 2. Zhvillimi i shpejtë i industrializimit dhe urbanizimit, 3. Krizat ekonomike dhe 4. Paraqitja e formave të organizuara të sjelljeve devijante, delikuate dhe kriminale, për të cilat karakteristikë e veçantë është ndërlidhja dhe veprimi grupor.¹⁵

Këto teori sociologjike që shpeshherë quhen edhe si teori sociopsikologjike, për definimin

¹³ Po aty

¹⁴ A. Dida, Patologjia Shoqërore e të Miturve në Kosovë, Prishtinë 1996, faqe 60

¹⁵ A. Dida, Patologjia Shoqërore e të Miturve në Kosovë, Prishtinë 1996, faqe 59

dhe sqarimin e shkaqeve dhe pasojave të dukurive sociopatologjike në shoqëri, bazohen në sqarimin e këtyre nocioneve: kultura, bashkësia, çorganizimi shoqëror, normat, sistemi vleror dhe ndeshja e vlerave si konflikt kulturor, kontrolli shoqëror dhe devijimi etj.

Sipas sociologve dhe teorive sociologjike, trajtimi i delikuencës së të miturve është shumë i kushtëzuar me një studim shkencor kompleks të cilin gjithsesi duhet të adaptuar duke bërë dallime në kohë të caktuar dhe nëpër mjedise të caktuara.

Sipas kësaj rëndësi të posaçme dhe kryesore në paraqitjen e veprave penale nga të miturit kanë faktorët e jashtëm veçanërisht faktorët shoqërorë dhe rrethanat e tjera në të cilat kryerësi i veprave penale jeton dhe vepron.

Disa nga këta faktorë padyshim janë: kushtet ekonomike, kushtet e jetës, kushtet familjare, mungesa e kontrollit të duhur nga ana e prindërve, përfshirja e të miturve në grupe të ndryshme, shfrytëzimin e kohës së lirë, konsumimin e alkoolit, substancave narkotike, pjekurin intelektuale etj.¹⁶

4. Trajtimi komperativ i delikuencës së të miturve

Delikuenca e të miturve në mënyrën komperative më së shumti merret me studimin e legjislacioneve penale për të miturit të vendeve të ndryshme të botës. Është metodë shkencore e cila i shërben delikuencës së të miturve për njohjen e të drejtave penale për të miturit në shtetet e ndryshme. Konsiderohet si instrumenti kryesorë për studimin e delikuencës së të miturve nacionale.

Duke u njoftuar me zgjidhjet dhe të arrituarat progresive në çështjet lidhur me delikuencën e të miturve të vendeve të tjera, formohet platforma dhe akceptohen solucione konkrete për përgaditjen dhe nxerrjen e ligjeve apo kodeve penale në shtetin përkatës, kështu është vepruar edhe në Republikën e Kosovës për nxerrjen e kodit KODI NR. 06/L-006 I DREJTËSISË PËR TË MITUR, pra janë analizuar të gjitha kodet dhe ligjet për të mitur të shteteve të ndryshme dhe është nxjerrë ky kod i cili është edhe sot është në fuqi, mirpo gjithmonë duke u bazuar në traditat dhe në faktorët e mbrenshëm të shtetit.

Pas shtjellimit të kodeve të ndryshme të shteteve kryesisht perendimore e në disa raste bëhet edhe analizimi i kodeve të shteteve fqinje që janë afër Kosovës siç janë: Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kroacia, Bullgaria etj.

Me çrast, u përvetësuan të gjitha zgjidhjet progresive lidhur me kodin për të miur të shteteve të tjera, që janë në fuksion të mbrotjes më efikase të vlerave shoqërore dhe të individëve në

¹⁶ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 35, 36

luftimin e kriminalitetit dhe parandalimin e tij tek të miturit.

4.1. Aspektet krahasimore me Republikën e Shqipërisë

Në shqipëri prej periudhës 1990-2006 gjithë komponentët e sistemit të drejtësisë për të mitur kanë qenë në një proces reformues te ndryshueshëm në mënyrë të pandërprerë. Kjo për një arsye të vetme dhe të thjeshtë se jo gjin një çka përmban ligji dhe konventat formale janë praktike dhe të zbatueshme në praktikë dhe në sistemin shoqërorë. Legjislacione e të gjithave vendeve të ndryshme të botës kanë nevojë për përditësime dhe ndryshime, për një arsye të thjeshtë se legjislacione janë statike kurse shoqëria janë gjitmonë në procesë dinamik dhe të ndryshueshëm ndryshueshëm.

Të dhënat statistikore për kriminalitetin e të miturve gjatë viteve 2002 dhe 2003 pasqyrojnë një rritje graduale të fenomenit. Në vitin 2002 dhe 2003 nga kjo kategori e të dhënave ishin rrespektisht 251 për krime dhe 23 për kundërvajtje, dhe në vitin 2003, 259 për krime dhe 49 për kundërvajtje.¹⁷

Politika kriminale e zbatuar gjatë viteve 2002-2004 tregon se numri i personave të dënuar për krime është në rritje nga viti në vit, dhe kjo për shteti shqiptarë duhet një llojë alarmi se diçka nuk po funksionon në politikën kriminale të shtetit.¹⁸

Duke u bazuar në Kushtetutën e R. Shqipërisë konkretisht të neneve 81, pika 2, dhe nenit 83, pika, 1.¹⁹

Kodi I drejtësis penale për të mitur (KDPM), përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla proceduarale lidhur me hetimin, ndekjen penale, procesin gjyqësorë, ekzekutimin e vendimit të denimit penal, rehabilitimin e një të mituri I cili është I përfshirë në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë ose dëshmitarë të veprës penale.

Qëllimet kryesore të KDPM janë të bazuara në disa pika, ku pikat kryesore do ti shtjellojmë në vijim.

1. Të garantojë një kuadër ligjorë mbi drejtësin penale për të mitur që është në përputhje me Kushtetutën, Koventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), për të drejtat e fëmijëve dhe standarteve e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më lartë të të miturit.

2. Të promovojë riintegrimin e të miturit në konflikt me ligjin penal dhe që I mituri të luajë

¹⁷ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 62

¹⁸ Po aty

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

në shoqëri një rol sa më të dobishëm.

3. Të garantojë risocializimin dhe reabilitimin e të miturit që ka kryer vepër penale.
4. Të mbrojë të drejtat e të miturit në raste kur është dëshmitar ose viktimë e veprës penale.
5. Të parandalojë riviktizimin dhe viktimizimin e dytë të të miturit, I cili më parë ka qenë viktimë e një veprë penale.
6. Të parandalojë përsëritjen e veprave penale nga ana e të miturit.
7. Të mbrojë parimet e rendit public në procesin e administrimit të drejtësisë penale për të mitur.
8. Të rrisë përgjegjësinë dhe profesionalizmin e organeve kompetente në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur.
9. Të garantojë masa educative dhe parandaluese për të miturit që kryejnë vepra penale dhe të sigurojë ngritjen e mekanizmave mbikëqyrës për zbatimin e tyre.²⁰

4.2 Aspektet krahasimore me Republikën e Maqedonisë së Veriut

Ligji i cili në Republikën e Maqedonisë gjen zbatim prej 01.12.2013 dhe i cili sipas nenit 19 të ligjit për drejtësi për fëmijë, si të mitur e trajton çdo person deri në moshë 18-vjeçare, kurse fëmijë në rrezik e trajton çdo person i cili ka mbushur 7-vjet kurse nuk i ka të mbushur 18-vjet, në vazhdim si kategori e veçantë trajton fëmijët në rrezik i cili ka mbushur 7-vjet kurse nuk i ka të mbushur 14-vjet. Një trajtim i veçantë për fëmijët në rrezik prej moshës 14-18 vjeçare. Fëmijë në ndeshje me ligjin për fëmijët prej 14-16 vjeç si dhe fëmijë në përplasje me ligjin të moshës mbi 16-vjeçare.²¹

Posaçërisht për këtë kategori nga aspekti i zbatimit të sanksionit është i paraparë trajtim i posaçëm penalo-juridik, barazuar në atë të fëmijëve i arsyetueshëm nga dy arsye. E para, është e mundur të rritur më të rinj t'i gjykohe për vepër që e ka kryer si i mitur, për shkak të asaj që vepra është zbuluar më vonë ose për shkak të procedurës më të zgjatur. Në këtë rast nuk do të ishte e arsyeshme kryerësit t'i shqiptohet dënim i paraparë për kryes të rritur, sepse dënimi paraqet fajin, kurse pyetja e fajit siç pamë është e zgjedhur në mënyrë të ndryshme kur kemi të bëjmë me vepra të kryera nga fëmija. Çështja tjetër, është e mundur po ashtu vepra të jetë e kryer nga personi i rritur i ri që sipas shkallës së zhvillimit shpirtëror nuk dallon prej atij të të miturit. Edhe në këtë rast do të ishte e pa arsyeshme që kryerësit e tillë t'i shqiptohet dënim për të rritur i cili përsëri paraqet fajin dhe faji-shkallën e pjekurisë që nën-

²⁰ Ligji Nr. 37/2017 Kodi I Drejtësisë Penale për të Mitur, Neni 1

²¹ Ligji mbi të Drejtat e Fëmijëve I Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare Nr.143), 2013

kupton aftësinë për kuptimin e rëndësisë së veprës së kryer.²²

Këta janë shkaqet për shkak të së cilave Ligji në fjalë dallon dy situata: shqiptimin e sanksioneve për persona të rritur për vepra të cilat i kanë kryer si të mitur dhe shqiptimin e masave edukuese personave të rritur më të rinj.

Këtë çështje ligji në fuqi e rregullon sipas nenit 69/16, i cili në alinenë e parë parasheh se personi i rritur i cili i ka mbushur 21 vjet nuk mund të gjykohet për veprimet të cilat janë të parapara si vepra penale nëse i ka kryer në periudhën e moshës 14-16 vjeçe, kurse në alinenë e dytë, të po të njëjtit nenë parashihet se personi i rritur i cili i ka mbushur 21 vjet, mund të gjykohet për veprimet të cilat janë të parapara si vepra penale nëse i ka kryer në periudhën e moshës 14-16 vjeçe, në qoftë se sipas kodit penal për veprën konkrete është i paraparë dënimi me burg më shumë se 5 vjet.

Sipas ligjit të vjetër të KPM së pari parasheh ndalesë për personin e rritur që ka mbushur 21 vjet të dënohet për vepër penale që e ka kryer si i mitur më i ri. A contrario, prej ndalesës së tillë del se personi i rritur mund të dënohet për çdo vepër që e ka kryer si i mitur më i vjetër.

Edhe sipas ligjit të vjetër, nëse personi i rritur në kohën e gjyimit nuk i ka mbushur 21 vjet mund të gjykohet vetëm për vepra penale për të cilat është paraparë dënim më i rëndë se 5 vjet burg. Bëhet fjalë për vepra që kryerësi i ka kryer si i mitur më i ri në këtë rast kryerësit mund t'i shqiptohet vetëm masë adekuate edukuese e entit. Gjatë vlerësimit a do të shqiptohet masë e tillë gjyqi do t'i merr parasysh të gjitha rrethanat e rastit, posaçërisht të veprës së kryer, koha që ka kaluar prej realizimit të saj, sjelljet e kryerësit edhe qëllimet e masës edukuese.²³

Personit të rritur i cili e ka kryer veprën penale si i mitur më i vjetër mund t'i shqiptohet masë edukuese adekuate ose dënim për burg më të rritur. Në këtë rast nuk ka rëndësi nëse në kohën që gjykohet kryerësi i rritur nuk i ka plotësuar 21 vjet ose është mbi atë moshë. Gjatë vlerësimit cilin sanksion do ta shqiptojë gjyqi duhet t'i merr parasysh të gjitha rrethanat në rastë posaçërisht rëndësinë e veprës, kohën e kaluar prej kryerjes së saj si dhe qëllimi që duhet të arrihet me këtë sanksion. Me përjashtim personit të mitur i cili në kohën e gjyimit i ka mbushur 21 vjet gjyqi mund që në vend të dënimit për të mitur t'i shqiptojë burg ose dënim me kusht. Dënimi me burg i shqiptuar në këtë rast në raport me rehabilitimin shlyerjen e dënimit dhe pasojat juridike nga dënimi, ka të njëjtin veprim juridik si edhe dënimi me burg për të mitur.²⁴

Personit të rritur më të ri të cilit mund t'i shqiptohet masë edukuese gjyqi me kushte të

²² Ligji mbi të Drejtat e Fëmijëve I Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare Nr.143), 2013, Neni 19, 20

²³ Po aty

²⁴ E.Sahiti & I. Zejneli, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, faqe 325, 330

parapara me ligj mund t'i shqiptojë të gjitha masat e sigurisë. Masa e shqiptuar edukuese mund të zgjasë më së shumti deri në mbushjen e moshës 21 vjet. Kurse në ligjin e ri për drejtësi për fëmijë, kjo çështje trajtohet në nenin 70 me dallim të vetëm tek masa e shqiptuar edukuese e cila mund të zgjasë më së shumti deri në mbushjen e moshës 23 vjeçare,

Me zgjedhjen e tillë ligji shkon në përmbushjen e njoftimeve të verifikuara shkencore për procedimin dhe mos baraspeshimin e zhvillit- mit te procesit që nuk mund të futet në proceset e vendosura ligjore (nuk e arrin pjekurinë të gjithë me mbushjen e moshës 18 vjet) dhe edhe mëpak arsyeton ndërlidhja mbi proceset e tilla në ndarje të holla në trajtimin penalo-juridike.²⁵

²⁵ Po aty

Kapitulli II

1. Trajtimi juridiko penal i delikuencës së të miturve

Vepra penale nuk kryejnë vetë personat e moshës madhore por kryejnë edhe personat e mitur ne forma dhe rrethana të ndryshme dhe për arsye të ndryshme. Përkundër faktit se për nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore veprat penale të të miturve janë pothuajse identike e në disa raste edhe më të rrezikshme se veprat penale që kryhen nga personat madhorë, mirpo gjithmonë trajtimi i të miturve në të drejtë penale është më i butë dhe më i favorshëm për të miturit pra për personat që janë ndër moshën 18 vjeç.

Pozita penalo-juridike e të miturve është vetëm një rrethanë që kushtëzon zbatimin e masave të legjislacionit penal si mjet i fundit në luftimin e delikuencës së të miturve. Legjislacioni penal edhe pse dukshëm e ka rregulluar pozitën penalo juridike e të miturve nuk ka arritur sa duhet të ndikojë në luftimin më të suksesshëm të delikuencës së të miturve. Mirëpo edhe normat penalo juridike më bashkëkohore nuk do të kenë efekte të pritura kriminalo-politike, nëse njëkohësisht nuk bëhen përtëritje përkatëse kadrovike, organizative dhe normative në zbulimin, gjykimin e të miturve dhe ekzekutimin e sanksioneve ndaj tyre.²⁶

Organet e drejtësisë që mirren me çështjen e të miturve janë Gjykata kompetente të cilët janë gjykata për të mitur, organet e tjera të specializuar lidhur me të miturit siç janë Qendra për punë sociale, Prokuroria publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe entet për zbatimin e sanksioneve për të mitur.

Kontributë kryesorë lidhur me kryerjen e veprave penale nga të miturit dhe trajtimin e tyre nga ana e organeve të drejtësisë pasi të jetë kryer vepra penale ka dhënë Organizata e Kombeve të Bashkuara, pas miratimit të rregullave minimale në lidhje me dhënjën e drejtësisë për të mitur, të njohura me emërtimin Rregullat e Pekinit e 29 Nëntorit të vitit 1985. Janë rregulla bazike dhe minimale ku secili shtet antarë i OKB duhet ti respektojë lidhur të miturit që kryejnë vepra penale.²⁷

Rregullat e Pekinit përmbajnë disa parime ku secili shtet duhet ti respektojë i cili është antarë i OKB-së.

Parimi kryesorë është që mosha e përgjegjësisë penale e të miturit nuk duhet të jetë shumë e ultë por as shumë e lartë.

Parimi që aplikimi i së drejtës penale ndaj të miturit të jetë mjet i fundit.

Parimi i favorizimit të masave të diversitetit.

²⁶ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 37

²⁷ Po aty

Parimi i mbrojtjes në procedurë për të mitur. Siç është i paraparë edhe për personat madhorë. Parimi i kufizimit të aplikimit të masave të cilat konsistojnë në privimin e lirisë.²⁸

Legjislacionet e vendeve të ndryshme dallojnë për sa i përket moshës për përgjegjësin penale, pra ka dallime nga njëri shtet në tjetrin. Si kufiri më i ultë i moshës së të miturve cilësimi i tyre si kryes të sjelljeve kriminale në disa shtete bashkohore merret moshë 7 vjeçare siç janë shtetet si: Burma, Egjipti, Iraku, moshë 9 vjeçare si moshë e përgjegjësisë penale më të ultë është në Izrael, Jordan, Filipine etj. Moshë 10 vjeçare si moshë e përgjegjësisë penale konsiderohet në Bolivi, Paraguaj dhe në shumicën e shteteve të Amerikës Latine.

Turqia dhe irani e kanë moshën 11 vjeçare. Panama, Greqia dhe disa vende të tjera moshën 12 vjeçare. Ndërsa Zvicra, Danimarka, Suedia si moshën më të ultë e marrin moshën 15 vjeçare për dallim nga Finlanda dhe Kili, si moshë më të ultë të përgjegjësisë penale marrin moshën 16 vjeçare.²⁹

Normat e legjislacionit penal janë mjet i domosdoshëm për funksionimin e judikaturës penale, e cila i realizon qëllimet dhe detyrat e veta vetëm duke vepruar dhe i respektuar këto norma. Duke u mbështetur në këto norma merren vendime dhe aktvendime që kanë për qëllim zbatimin e ligjit penalë në praktikë si arsye kryesore luftimin e kriminalitetit.

Trajtimi me të miturit dhe kryerja e krimeve nga ana e të miturve nuk është vetëm problem nacional i Shtetit të Kosovës, por është problem botërorë, dhe me këtë problematikë ndeshen të gjitha vendet e botës pa dallim, kuptohen se për shumë arsye siç janë faktorët e ndryshëm, në disa vende është më tepër i theksuar e në disa është më pak i theksuar.

2. Parimet bazë që u referohen personave të mitur

Koncepti themelorë i Delikuencës për të mitur në Republikën e Kosovës, është esenca e instucioneve të përcaktojnë disa parime, mbi të cilat është e bazuar edhe e drejta penale ku janë parimet e të drejtës penale, por edhe parimet e delikuencës së të miturve ku thuhet se parimet e tyre janë identike me disa ndryshme fare të vogla tek parimet e delikuencës së të miturve.

2.1. Parimi i Ligjshmërisë

Ndër parimet kryesore dhe esenciale në delikuencën e të miturve është parimi i ligjshmërisë ku nënkuptojmë me këtë parim se: nuk ka vepër penale, nuk ka dënim apo sanksion tjetër penal juridik pa ligj, pra (Nullum crime, nulla poena sine lege). Pra me fjalë të tjera askujt nuk mund ti shqiptohet dënim ose ndonjë sanksion tjetër penal për vepër, e cila para se të kryhet

²⁸ I. Salihu, E Drejta Penale për të Mitur, Prishtinë 2005, faqe 15,16

²⁹ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 44

nuk ka qenë e paraparë me ligj apo edhe me marveshje ndërkombëtare të ratifukara në parlamentin e Republikës së Kosovës në pajtimin me Kushtetutën e saj.

Ligji është burim themelorë i së drejtës penale për të mitur, vetëm ligji, i cili nekuptojmë shprehjen e vullnetit të përgjithshëm dhe aprovet në procedurë demokratike parlamentare nga ligjvënësit ose ndryshe të njohur edhe si deputetët e kuvendit të Republikës së Kosovës mundet të ketë funksion të tillë, kurse ndalesat dhe sanksionet e tij të gëzojnë përkrahje të përgjithshme.³⁰

Është e pakontestueshme se sot parimi i ligjshmërisë paraqet rrjedhsmëri të përgjithshme civilizuese, standart që la domethënie të ius cogens për çdo shtet bashkohorë në ditët e sotme. Rëndësia kruciale e këtij parimi, është se nëpërmjet detyrës dhe obligimit të ligjvënësit, duhet të përcaktojë veprën penale dhe dënimet që janë të domosdoshme, për arsye që të menjahohen të gjitha dilemat se çka është e ndaluar dhe çfarë pasoje juridike e godasin kryersin e veprës penale.

Përmbatja e parimit të ligjshmërisë përcakton në radhë të parë dy kërkesat esenciale të cialt janë: përcaktimin e figurës ligjore dhe ndalimin e veprimit retroaktiv të ligjit.³¹

2.2. Parimi i Humanizimit

Çdo i mitur i cili është i dënuar dhe i privuar nga liria duhet të trajtohet me humanizë, dhe të respektohet ingeriteti i ti personal si dhe të ruhet diniteti i tij edhe pse ka kryer vepër penale dhe është i dënuar.

Qëllimi kryesorë i këtij parimi është i paraparë me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që vërtetojnë statusin e pacenushëm të njeriut, pozicionin e tij qendrorë në sistemin e parimit të njohjes si prioritet i lirive dhe të drejtave të njeriut kundrejt shtetit dhe pushtetit represiv.

Parimi i humanizimit mbështet kryesisht në Kushtetutat e shteteve nacionale, ku janë të përqendruara në ndalesat e dënimeve të ashpra dhe brutale, të cilat janë të panevojshme dhe jo humane, si dhe proklamon pacenushmërinë e integritetit fizik dhe moral të njeriut dhe ndalon çfardo forme të torturës, veprime apo ndëshkime jo humane, të ashpëra dhe jo njerzore.

Gjatë hulumtimit të parimit të humanizimit dhe trajtimit të Kushtetutës së Republikës së Maqedonis së Veriut, me metodën krahasimore të legjislacioneve e vërejmë se në nenin 39, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonis së Veriut thuhet: gjatë matjes së dënimit

³⁰ I. Zejneli, V. Kambovski, E Drejta Penale, Tetovë 2018, faqe 38

³¹ Po aty, faqe 39

gjykata mund të marrë parasysh edhe jetën e mëparshme të kryersit, mundësit e tij personale, sjelljen e tij pas veprës së kryer dhe rrethana e tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e kryersit.³²

Drejtimi kryesor i veprimit të këtij parimi është sfera e sanksioneve penalo-juridike. Koncepti themelor kriminalo politik, nga i cili nis ligjdhënsi është përcaktimi i kufirit racional i represionit penalo-juridik dhe sistemi penal human.

2.3. Parimi i pafajsisë

Një ndër parimet themelore në të cilat bazohet procedura bashkëkohore penale është parimi i prezumimit të pafajësisë. Në të drejtën vendore procedurale supozimi (Prezumimi) i pafajësisë është i definuar në pajtim me dokumentet ndërkombëtare.

Në mënyrë që secili person i dyshuar apo i akuzuar se ka kryer vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të mos vërtetohet fajësia e tij me vendimin e formës së prerë të gjykatës. Prezumimi i pafajësisë njihet gjatë tërë procedurës penale, por ka të bëjë edhe me veprimet që i paraprinë asaj, me të cilat organet shtetërore mbledhin shënime për veprën penale. Supozimi procedural i pafajësisë është i ashtuquajtur i supozim i përkohshëm i cili vlen deri sa mos të dëshmohet e kundërta.

Në teorinë e procedurës penale supozimi i pafajësisë nënkupton:

- Se i pandehuri ka të drejtë, por jo edhe obligim që të mbrohet;
- Se i pandehuri lirohet nga barra e provës dhe i takon privilegji kundër vetakuzimit (ang. Privilege against incrimination);
- Se obligimi apo barra e provave bie mbi paditësin e autorizuar;
- Se në rast dyshimi, gjykata gjithmonë duhet të veprojë në dobi të pandehurit.

Gjithashtu, ky parim është në lidhje të ngushtë edhe me respektimin e të drejtës për integritet personal dhe dinjitet njerëzor;

- të drejtën për të heshtur; njoftimin me lëndën e akuzës dhe nxjerrjen e aktgjykimit lirues për arsye të mungesës së provave të veprës penale.³³

Një nga pasojat e drejtpërdrejta të supozimit të pafajësisë është dispozita ligjore sipas të cilës dyshohet në aspektin e ekzistimit të fakteve të cilat janë relevante për rastin apo dyshimi në raport me aplikimin e ndonjë dispozite të ligjit penal të interpretohet në dobi të pandehurit dhe të drejtave të tij. Fjala është për parimin in dubio pro reo. Në pajtim me këtë parim

³²I. Zejneli, V. Kambovski, E Drejta Penale, Tetovë 2018, faqe 47

³³Kodi Nr. 04/L-123 I Procedurës Penale, Neni 3

gjykata nxjerr aktgjykimin lirues, jo vetëm në rastin e vërtetimit të pafajësisë së të pandehurit por edhe atëherë kur nuk dëshmohet fajësia e të pandehurit. Pra, çdo dyshim për ekzistimin e ndonjë fakti relevant juridik duhet të shprehet në dobi të të pandehurit. Në këtë kuptim, ligjvënësi e obligon gjykatën që ta vlerësojë në mënyrë të ndërgjegjshme çdo provë veç e veç, kurse lidhur me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerr përfundimin lidhur me argumentimin e ndonjë fakti.³⁴

Parimi in dubio pro reo përmban dy rregulla. Rregulli e parë ka të bëjë me faktet të cilat shkojnë në dëm të të pandehurit. Këto fakte duhet të jenë të vërtetuara me sigurinë e plotë (p.sh. në të drejtën anglo - amerikane ky është standard argumentimi ”jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm”. Nëse ekziston dyshimi në raport me këto fakte atëherë ato nuk mund të merren si të vërtetuara, gjegjësisht konsiderohen të pavërtetuara (inekzistente).

Rregulla e dytë është e lidhur për faktet të cilat shkojnë në dobi të të pandehurit. Këto fakte merren si të vërtetuara madje edhe atëherë kur ato janë vetëm probabile (të besueshme), gjegjësisht nëse dyshohet në ekzistimin e tyre, madje edhe atëherë kur ekzistimi i fakteve në dëm të të pandehurit është më i besueshëm (probabil).³⁵

Parimi ne bis in idem

Ndalimi i gjykimit të sërishëm për të njëjtën çështje penale është e shprehur përmes parimit *ne bis in idem*. Ky parim është paraparë në Protokollin e 7 të KEDNJ. Dokumentet e përmendura ndërkombëtare parashohin që askush nuk mund të gjykohet përsëri, gjegjësisht askush nuk mund të dënohet përsëri në procedurën penale të të njëjtit shtet për vepër penale për të cilën ka qenë i liruar me vendimin e formës së prerë, apo i dënuar në pajtim me ligjin dhe procedurën penale të atij shteti neni 4. par. 1. Protokollin 7 i KEDNJ. Rezultati i aplikimit i këtij parimi bazohet edhe në parashikimin e përjashtimeve të tij në atë kuptim që mund të hapet përsëri shqyrtimi i lëndës së caktuar nëse ekzistojnë provat për faktet e reja apo për faktet e zbuluara rishtazi, ose nëse në procedurën paraprake ka ardhur deri te shkelja esenciale e cila ka mundur të ndikoj në zgjidhjen e rastit.³⁶

Ky parim nuk mund të derogohet në kohë të luftës apo në ndonjë rrethanë të jashtëzakonshme neni 4. par 3. i Protokollit 7. KEDNJ, dhe neni 15 i KEDNJ. KPPPK, thekson se askush nuk mund të jetë i ndjekur as i dënuar për veprën penale për të cilën është liruar apo është dënuar me vendimin e formës së prerë të gjykatës Neni 4.³⁷

³⁴ I. Zejneli, V. Kambovski, E Drejta Penale, Tetovë 2018, faqe 46

³⁵ Kodi Nr. 04/L-123 I Procedurës Penale,

³⁶ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Protokollin 7, Neni 4

³⁷ Po aty

Parimi *ne bis in idem* përfshinë dy kushte kumulative:

- a) që procedura penale tashmë është zhvilluar kundër personit të caktuar për veprën e caktuar penale dhe
- b) se tashmë është nxjerrë vendimi i formës së prerë i gjykatës lidhur me atë lëndë penale.

Për shqyrtimin e parimit *ne bis in idem* janë të lidhura edhe nocionet e formës së prerë formale dhe materiale. Sipas rregullit, që të dy këto forma të prera vijnë në të njëjtën kohë. Vendimi formal i formës së prerë është ai vendim i cili nuk mund të kundërshtohet me mjete juridike, pra kur ankesa nuk lejohet.

Forma e prerë e vendimit në kuptimin material nënkupton ndalesën e zhvillimit të sërishëm të procedurës penale për atë çështje penale për të cilën është nxjerrë vendimi i formës së prerë i gjykatës kompetente (*ne bis in idem*), gjegjësisht procedura penale e përfunduar në atë mënyrë mund të rishikohet vetëm në bazë të dispozitave mbi rishikimin e procedurë penale, si mjet i jashtëzakonshëm juridik.³⁸

2.4. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës është i rregulluar edhe përmes legjislacioneve vendase si dhe përmes konventave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të miturit, sipas nenit të 5 të ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës të Republikës së Kosovës, ku sqarohet Interesi më i mirë i fëmijës dhe më i lartë në disa pika kryesore.

1. Të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës.
2. Ky Ligj, si dhe aktet e tjera juridike që rregullojnë çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të mirë të fëmijës.
3. Interesi më i mirë i fëmijës kërkon një përpjekje tërësore për të siguruar integritetin fizik, psikologjik, moral dhe shpirtëror të fëmijës dhe për të promovuar dinjitetin njerëzor, duke marrë parasysh karakteristikat individuale dhe gjendjen sociale të fëmijës.
4. Për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës duhet të respektohen parimet si në vijim:
 - 4.1. familja është përgjegjëse kryesore për t'u kujdesur dhe për të mbrojtur fëmijët;

³⁸ I. Zejneli, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, faqe 45,46

institucionet ndihmojnë familjet me këtë detyrim dhe ndërhyjnë vetëm kur familja nuk është në gjendje, apo nuk është e aftë ose ka nevojë për ndihmë për të mbrojtur fëmijën.

4.2. qëndrueshmëria duhet të jetë qëllim kyç, duke zgjedhur intervenimin sa më të pakët në jetën e fëmijës për të siguruar stabilitetin e marrëdhënieve personale të fëmijës dhe të shoqërisë, mjedisit dhe për të garantuar vazhdimësinë e arsimimit, trajnimit të fëmijës, ose punësimit.

4.3. vendimet administrative dhe gjyqësore që prekin fëmijën duhet të merren dhe zbatohen me shpejtësi dhe pa vonesa të paarsyeshme.

4.4. prindërit, kujdestarët dhe fëmija marrin pjesë në të gjitha fazat e procedurës përveç nëse është në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës.

4.5. mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar.

4.6. historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen.

4.7. vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave me të cilët ai ka lidhje gjinore/farefisnore, shoqërore dhe/ose shpirtërore, dhe të gjitha vendimet dhe iniciativat që janë objekt i këtij Ligji, duhet të marrin parasysh individualitetin, moshën dhe pjekurinë, gjuhën amtare, seksin, gjininë, identitetin, gjendjen shëndetësore dhe aftësitë e veçanta të fëmijës me qëllim të ruajtjes së identitetit etnik, racor, fetar dhe kulturor të fëmijës, sipas rrethanave.

5. Interpretimi i interesit më të mirë të fëmijës duhet të jetë në tërësi në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës si dhe asnjë interpretim i supozuar i asaj se çka është në interesin më të mirë të fëmijës nuk mund të justifikojë shkeljen e çfarëdo të drejte të njohur nga Konventa.

Gjithashtu për parimin e interesit më të lartë të fëmijës merret edhe legjislacioni i Shtetit Shqiptarë, ku sipas nenit 10 të Kodit për Drejtësin Penale për të Mitur (KDPM), trajtohet në këtë mënyrë:

1. Organet kompetente në çdo vendim dhe veprimtari të ndërmarrë në zbatim të këtij Kodi, duhet të vlerësojnë me përparësi interesin më të lartë të të miturit.

2. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit,

shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.³⁹

2.5. Parimi i mbrotjes nga diskriminimi

Republika e Kosovës ka përfshirë në Kushtetutën e saj (neni 22), Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, dhe protokollet e saj; Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj, Konventën Kornizë të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventën për të Drejtat e Fëmijës, si dhe Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore Jonjerezore dhe Poshtëruese.⁴⁰

Marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare përbëjnë pikën më të gjerë të referencës ligjore për të garantuar të drejtat dhe liritë e njeriut, veçanërisht fëmijës, dhe kanë prioritet në rast konflikti ndaj dispozitave dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Përveç instrumenteve ndërkombëtare që janë të aplikueshme drejtëpërdrejtë në

Republikën e Kosovës, Kushtetuta dhe dispozitat tjera ligjore që janë në fuqi në Kosovë, në mënyrë gjithëpërfshirëse i garantojnë fëmijës, barazinë dhe realizimin e parimit të trajtimit të barabartë të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës,

Nocioni i diskriminimit sipas Ligjit për mbrotjen nga diskriminimi në neni 3 po të këtij neni thuhet se: “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.⁴¹

Duke analizuar dhe shtjelluar Kodin për Drejtësin Penale për të Mitur (KDPM), të Republikës së shqipërisë konkretisht nenit 11 ku thuhet: se çdo i mitur në konflikt me ligjin, viktimë ose

³⁹ Ligji Nr. 06/L-084, Për Mbrojtjen e Fëmijës, Neni 5

⁴⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22

⁴¹ Ligji Nr. 05/L-021, Për Mbrojtje nga Diskriminimi Neni 3

dëshmitar, pavarisist nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politie, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prinërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetsore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit.⁴²

Kurse në Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, në Republikën e Kosovës, nocioni i diskriminimit trajtohet në neni 1 po të këtij ligji ku thuhet se: 1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.⁴³

Kurse në neni 9 paraqitet se kush ka kompetenca ta ndëjk diskriminimin, denoncoj dhe ta luftoj atë, ku në nenin 9 thuhet:

1. Avokati i Popullit është Institucion i shtetit, i cili bënë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.

2. Avokati i Popullit ka këto kompetenca:

2.1. pranon dhe heton parashitresat e personave, ndërmjetëson, jep mendime dhe rekomandime për rastet konkrete të diskriminimit;

2.2. ofron asistencë viktimave të diskriminimit në bërjen e ankesave kundër diskriminimit dhe ofron informatat e domosdoshme personave që kanë paraqitur një ankesë për diskriminim në lidhje me të drejtat e tyre, për detyrimet dhe mundësitë e gjykatës, si dhe për mjetet tjera mbrojtëse;

2.3. Avokati i Popullit ka autorizim të hetoj ose të veproj mbi ndonjë ankesë të parashtruar ose me vetë-iniciativë (ex-officio) kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga subjektet e sektorit publik;

2.4. u drejtohet organeve të prokurorisë dhe të hetimit direkt me një kërkesë për fillimin e hetimit të kundërvajtjeve dhe veprave penale dhe kërkon fillimin e procedimit diciplinor të

⁴² Ligji Nr. 37/2017, Kodi I Drejtës Penale për të Mitur, Neni 11

⁴³ Ligji Nr. 05/L-021, Për Mbrojtje nga Diskriminimi, Neni 1

zbatueshëm;

2.5. informon publikun për rastet e diskriminimit dhe ndërmerr masa për promovimin e barazisë, të drejtave të njeriut dhe mos diskriminimin;

2.6. përcjell zbatimin e këtij ligji dhe inicon ndryshimin e dispozitave për zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga diskriminimi;

2.7 ofron këshilla, udhëzime dhe mbështetje, subjekteve të sektorit publik dhe privat mbi praktikën e mirë në promovimin e barazisë, në përshtatjen ndaj diversitetit dhe parandalimin e diskriminimit mbi bazat e mbuluara nga Ligji përkatës për Barazi Gjinore dhe nga ky Ligj, si dhe jep rekomandime për marrjen e masave për promovimin e barazisë, përshtatjen ndaj diversitetit dhe/ose luftimin e diskriminimit.

2.8. ofron këshilla, mbështetje dhe udhëzime organizatave jo-qeveritare dhe partnerëve social në praktikën e mirë dhe efektive në luftimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë, në veçanti organizatave që merren me çështjet e barazisë dhe jo-diskriminimin; 2.9. jep mendime në projekt-aktet normative për mbrojtjen nga diskriminimi;

2.10. mbledh të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera, realizon studime, hulumtime dhe trajnime, në lidhje me diskriminimin;

2.11. bashkëpunon me partnerët social, organizatat jo-qeveritare, që merren me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me mekanizmat përkatëse të shteteve tjera që merren me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe me institucionet dhe bashkësitë fetare të regjistruara në Kosovë;

2.12. paraqet raport të paku çdo vit në Kuvendin e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij Ligji dhe gjithashtu mund të hartojë raporte të veçanta për zbatimin e tij;

2.13. Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi;

2.14. mund të hartojë Kode të Praktikave të Mirë, për luftimin e diskriminimit dhe për promovimin e barazisë, të cilat, mund të përdoren si pikë referimi në rastet e diskriminimit.⁴⁴

Në përgjithësi, diskriminim konsiderohet çdo formë e dallimit, përjashtimit, kufizimit ose ndonjë preferimi, me qëllim të mohimit ose refuzimit të të drejtave të barabarta dhe mbrojtjes, si dhe paraqet mohim të parimit të barazisë dhe fyerje ndaj dinjitetit njerëzor. Varësisht nga arsyeja për trajtim të tillë, ne mund të flasim për “*diskriminim në baza racore, kombëtare, ngjyre, gjinie, religjioni, orientimi seksual, etj*”. Është shumë e rëndësishme të dihet se nuk mund të konsiderohet çfarëdo dallimi menjëherë edhe si diskriminim në

⁴⁴ Ligji Nr. 05/L-021, Për Mbrojtje nga Diskriminimi, Neni 9

kuptimin e abuzimit të të drejtave të njeriut. Përderisa ky dallim është i bazuar në kritere të arsyeshme dhe objektive, ai mund të justifikohet.

Tri elementet e diskriminimit: Në përgjithësi mund të identifikohen tri elemente që janë të përbashkëta për të gjitha format e diskriminimit:

veprimet të cilat kualifikohen si diskriminuese, si dallimi, përjashtimi, kufizimi dhe preferimi.

shkaqet e diskriminimit, pra karakteristikat personale si raca, ngjyra, prejardhja, origjina kombëtare/etnike, gjinia, mosha, integriteti fizik etj.

qëllimet dhe/ose pasojat e diskriminimit, të cilat kanë për qëllim, parandalimin e viktimave të ushtorojnë dhe/ose t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre fundamentale. Më pastaj, duhet bërë një dallim ndërmjet diskriminimit të *drejtpërdrejtë*, (duke përkrahur qëllimin), ku kryesi dëshiron të diskriminojë personin ose grupin dhe diskriminimit të *tërthortë* (ose të lidhur me pasojat), ku, qartazi, një dispozitë neutrale ose ndonjë masë *de facto*, favorizon një person ose një grup në krahasim me të tjerët.⁴⁵

3.Konventat Ndërkombëtare për trajtimin e të miturve

Për mbrotjen dhe respektimin e të drejtave të të miturve kontribut shumë të madh kanë dhënë konventat ndërkombëtare, ku mund të themi me gojën plot se të gjitha legjislacionet e vendeve nacionale të shteteve të ndryshme lidhur me të miturit, legjislacionet e tyre burojnë nga konventat ndërkombëtare, shtetet janë nënshkrues të këtyre konventave ndërkombëtare si dhe i kanë miratuar po ato konventa ndërkombëtare në parlamentet nacional ashtu siç i detyronë kushtetuta.

Kontribut kryesorë lidhur me të miturit ka dhënë Konventa mbi të drejtat e fëmijëve e miratuar nga asamblja e përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), më 20 Nëntorë, të vitit 1989.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve u firmos për një kohë shumë të shpejt nga 61 vende të botës, reagim i cili nuk është pa më parë, një llojë solidariteti dhe nevojë të nënshkruhet kjo marveshje nga shtetet e ndryshme të botës.

Deklarata ka hyrë në fuqi më 2 Shtator 1990, ku shënoi pikën kulminate për respektimin e drejtave të të miturve si dhe kujdesin e veçant të tyre.

Vetëm dy shtete ende nuk e kanë nënshkruar këtë Konventë Ndërkombëtare e ato shtete

⁴⁵ (Po aty)

janë: Somalia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Në Preambulën e kësaj Konvete në një pjesë të saj thuhet se: Duke mbajtur parasysh se domosdoshmëria për t'i dhënë një mbrojtje të posaçme fëmijës është pohuar në Deklaratën e Gjenevës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1924 dhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Kombet e Bashkuara më 20 nëntor 1959 dhe që është njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (në veçanti në nenet 23 dhe 24), në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (në veçanti në nenin 10) dhe në statutet e instrumentet përkatëse të agjencive të specializuara dhe të organizatave ndërkombëtare, që merren me mirëqenien e fëmijës, Duke mbajtur parasysh se, ashtu siç është thënë në Deklaratën e të Drejtave të Fëmijës “fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të posaçëm, përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, si para ashtu dhe pas lindjes”, Duke kujtuar dispozitat e Deklaratës mbi Parimet Shoqërore dhe Juridike lidhur me Mbrojtjen dhe Mirëqenien e Fëmijëve, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me vendosjen e fëmijës në një familje ushqyese dhe birësimin e fëmijës brenda dhe jashtë vendit; me rregullat minimale standard të Kombeve të Bashkuara mbi administrimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit) dhe të Deklaratës mbi Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Periudha të Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe Konflikti të Armatosur, Duke pranuar se në të gjitha vendet e botës ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe se është e nevojshme që këtyre fëmijëve t'u kushtohet një vëmendje e veçantë, Duke mbajtur parasysh si duhet rëndësinë e traditave dhe të vlerave kulturore të çdo populli në mbrojtjen dhe zhvillimin e harmonishëm të fëmijës, Duke pranuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve në të gjitha vendet, dhe veçanërisht në vendet në zhvillim, U morën vesh për sa vijon.⁴⁶

Pra duke u bazuar nga Preambula e kësaj Konvete, rëndësi kryesore i ipet fëmijës dhe mbrojtjes së tij, dhe respektimin të këtyre neneve të Konventës.

Dy nga disa nenet e kësaj Deklarate, konkretisht nenit 2, dhe nenit 9 thuhet se:

1. Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

⁴⁶ Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijëve, OKB 1989, Preambula

- Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.⁴⁷

Neni 9:

Shtetet Palë garantojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër dëshirës së tyre, përveç rastit kur autoritetet kompetente, në bazë të rishikimit gjyqësor, vendosin që, në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse kjo ndarje është e domosdoshme, në interesin më të lartë të fëmijës. Ky vendim mund të jetë i nevojshëm në raste të veçanta, si ai kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija.

- Në të gjitha rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha palët e interesuara duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në diskutim dhe të bëjnë të njohura mendimet e tyre.

- Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

-Kur ndarja është rrjedhojë e çdo mase të marrë nga një Shtet Palë, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja, (përfshirë këtu vdekjen për çfarëdo shkak, kur personi është i ndaluar nga shteti) e njërit ose të dy prindërve, ose të fëmijës, ky Shtet Palë, sipas kërkesës, u jep prindërve, fëmijës ose, kur është rasti, një anëtar tjetër të familjes, të dhëna të hollësishme mbi vendin ku ndodhen anëtarët ose anëtarët e familjes, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu, që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë në vetvete pasoja të dëmshme për personin ose personat e interesuar.⁴⁸

Për avansimin e të drejtave të të miturve dhe mbrotjen e tyre rol të madh dhe kruacial ka luajtur edhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, të datës 14 dhjetor, 1990.

Ku në pikën 1 të kësaj rregullore filitet për Prespektivat Themelore: 1. Sistemi i drejtësisë për të mitur duhet të mbështetet në të drejtat dhe sigurinë dhe të nxitë mirëqenien fizike dhe mentale të të miturve. Burgosja duhet të përdoret vetëm si mjeti i fundit.

2. Të miturit duhet të privohen nga liria e tyre vetëm në përputhje me parimet dhe procedurat

⁴⁷ Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijëve, OKB 1989, Neni 2

⁴⁸ Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijëve, OKB 1989, Neni 9

e mbarështruara në Rregullat e Kombeve të Bashkuara mbi Standardet Minimale për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekingut). Privimi nga liria i të miturit duhet të jetë shfrytëzim i mjetit të fundit dhe për periudhen minimale të domosdoshme, dhe ky duhet të jetë i kufizuar vetëm në rastet përjashtimore. Kohëzgjatja e sanksionit duhet të përcaktohen nga autoriteti gjyqësor, pa përjashtuar mundësinë e lirimit të mëhershëm të tij apo të saj.

3. Rregullat mëtojnë të krijojnë standarde minimale të pranuar nga Kombet e Bashkuara për mbrojtjen e të miturve në të privuar nga liria në të gjitha format, në përputhje me të drejtat e njeriut dhe me liritë themelore, dhe duke marrë parasysh efektet vështirësuese që kanë të gjitha llojet e arrestimit për nxitjen e integritetit në shoqëri.

4. Rregullat duhet të zbatohen në mënyrë të paanshme, pa diskriminim të çfarëdo lloji si ai i bazuar në racë, ngjyrë, gjini, moshë, gjuhë, fe, shtetësi, opinion politik apo tjetër, besim dhe praktika kulturore, pronë, lindje apo status familjar, origjinë etnike apo sociale, dhe aftësi të kufizuar. Besimi fetar dhe kulturor, praktikat dhe konceptet morale të të miturit duhet të respektohen.

5. Rregullat janë hartuar për të shërbyer si standarde të përshtatshme të referimit dhe për t'u dhënë kurajo dhe udhërrëfim profesionistëve të angazhuar në drejtimin e sistemit të drejtësisë për të mitur.

6. Rregullat duhet që të gatshme dhe në gjuhën e tyre t'u vehen në dispozicion personelit të sistemit të drejtësisë për të mitur. Të miturit të cilët nuk janë njohin mirë gjuhën e përdorur nga personeli i objektit të arrestit, duhet të kenë të drejtë për shërbime të përkthimit, pa pagesë dhe kurdo që kanë nevojë, veçanërisht gjatë ekzaminimit mjekësor dhe procedurave disiplinore.

7. Kurdo që është e dëshirueshme, shtetet do të përfshijnë Rregullat në ligjet e tyre apo rrjedhimisht do të amendojnë ligjet e tyre, në përputhje me mjetet juridike efektive për rastet e shkeljeve, përfshirë edhe kompensimet për cenimet e shkaktuara ndaj të miturve. Shtetet gjithashtu, do të monitorojnë zbatimin e Rregullave.

8. Autoritetet kompetente vazhdimisht duhet të përpiqen të ngrisin vetëdijen e opinionit të gjërë se kujdesi për të miturit në arrest dhe përgatitja për kthimin e tyre në shoqëri është shërbim shoqëror i rëndësisë shumë të madhe, dhe duke synuar këtë duhet ndërmarrë hapat për të avansuar kontaktet ndërmjet të miturve dhe bashkësisë vendore.

9. Asgjë në Rregulla nuk do të interpretohet si ndalesë për zbatimin e instrumenteve dhe standardeve relevante të Kombeve të Bashkuara dhe për të drejtat e të miturve, të pranuar nga bashkësia ndërkombëtare, të cilat janë më të përshtatshme për sigurimin e të drejtave,

përkujdesit dhe të mbrojtjes së të miturve, fëmijëve dhe të gjithë të rinjve.

10. Në rast se zbatimi praktik i Rregullave të veçanta të përmbajtura në pjesët II deri IV, paraqet ndonjë konflikt me Rregullat e kësaj pjese, përparësia e këtyre të fundit konsiderohet si kërkesë mbizotëruese.⁴⁹

Ndërsa në pikën e dytë të po kësaj rregullore, e cila është ndër më të rëndësishmet flitet për shtrirjen dhe zbatimin e këtyre rregullave ku thuhet në mënyrë decide: (a) I mitur është çdo person nën moshën 18 vjeçare. Mosha nën të cilën personi nuk guxon të privohet nga liria do të përcaktohet me ligj;

(b) Privimi nga liria do të thotë çdo formë e paraburgimit apo burgimit apo vënje e personit në ambient të arrestit publik apo privat, e të cilin ky person nuk mund ta lëshojë sipas vullnetit të vet, sipas vendimit të ndonjë autoriteti gjyqësor, administrativ apo autoritet tjetër publik.

12. Privimi nga liria duhet të bëhet në kushte dhe në rrethana të tilla që sigurojnë respektim e të drejtave të njeriut të të miturit. Të miturve të mbajtur në objekte duhet t'u garantohen përfitimet e aktiviteteve përmbajtësore dhe programet të cilat i shërbejnë përparimit dhe qëndrueshmërisë së shëndetit dhe vetreseptimit të tyre, nxitjes së ndjenjës së tyre të përgjegjësisë dhe kurajimit të atyre sjelljeve dhe shkathtësive të cilat ndihmojnë në zhvillimin e kapaciteteve të tyre si anëtarë të shoqërisë.

13. Të miturve të privuar nga liria, për asnjë arsye që ka të bëjë me statusin e tyre nuk do t'u mohohen të drejtat e tyre civile, ekonomike, politike, sociale dhe kulturore, titullar të të cilave janë sipas të drejtës kombëtare apo ndërkombëtare, dhe të cilat janë kompatible me privimin nga liria.

14. Mbrojtja e të drejtave individuale të të miturve me vëmendje të posaçme në ligjshmërinë e ekzekutimit të masave të paraburgimit do të sigurohen nga autoriteti kompetent, përderisa objektivat e integritetit social duhet të sigurohen përmes inspektimeve të rregullta dhe mjeteve të tjera të kontrollit të zbatuara në përputhje me standardet ndërkombëtare, ligjet dhe rregulloret kombëtare, përmes organeve të themeluara rregullisht dhe të autorizuar për të vizituar të miturit, dhe të cilët nuk i takojnë institucionit të paraburgimit.

15. Rregullat vlejnë për të gjitha llojet e objekteve në të cilat të miturit janë të privuar nga liria e tyre. Pjesët I, II, III, IV dhe V të Rregullave vlejnë për të gjitha objektet e burgut dhe institucionet tjera në të cilat mbahen ata, ndërsa pjesa III vlenë në veçanti për të miturit e arrestuar apo në pritje të vendimit gjyqësor.

⁴⁹ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, Rezuluta 45/113, 1990, pika 1

16. Rregullat duhet të implementohen në kontekst të kushteve ekonomike, sociale dhe kulturore të cilat mbizotërojnë në secilin shtet anëtar.⁵⁰

Kemi gjithashtu edhe Direktivat e OKB për parandalimin e kriminalitetit të të miturve (Direktivat e Riadit).

U miratuan me Rezolutën 45/112 të 14.12.1990 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB- së. Dokumenti përcakton disa parime themelore, ku i pari ka të bëjë me parandalimin e kriminalitetit të të miturve si një pjesë thelbësore e parandalimit të krimit në shoqëri.

Për këtë, adoleshentët duhet t'i drejtohen veprimtarive të dobishme larg sjelljeve kriminogjene (pika 1). Që të realizohen këto objektiva, Direktivat vendosin disa linja të parandalimit të përgjithshëm që duhet të ndiqen nga qeveritë. Vëmendje e veçantë iu kushtohet proceseve të socializimit ku i mituri përfshihet më tepër si familja, arsimimi, komuniteti, mjetet e komunikimit.⁵¹

Duhet të hartohen politika të përshtatshme sociale të shoqëruara nga një legjislacion e organe të drejtësisë për të miturit që të njohin mirë problemet e të drejtat e tyre.

Për mbrojtjen e të drejtave të miturve kemi edhe rezoluta evropiane të cilat janë: Konventa Evropiane për ushtrimin e të drejtave të fëmijës e Strasburgut (25.01.1996). Kjo Konventë merr shkas nga KDF, duke i siguruar të miturit zotësinë për të vepruar në gjykim. Konventa ka si fushë zbatimi procedimet në të drejtën familjare, përfshi çështjet që kanë të bëjnë me pushtetin prindëror dhe të drejtën e vizitës së njërit prej prindërve.⁵²

Rezoluta e Këshillit të Ministrave të KE , 29.11.1978 mbi ndryshimet sociale dhe kriminalitetin e të miturve.

Ky akt vë theksin në mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe në rishikimin e sanksioneve dhe masave ndaj tyre, me qëllim që këto të marrin karakter edukues dhe socializues. Rezoluta iu drejtohet shteteve që të shmangin sa më tepër dënimet me burgim dhe të sigurojnë asistencën e duhur gjatë trajtimit institucional. I rëndësishëm është theksi që i vihet koordinimit të veprimtarive mes të gjithë organeve (shërbimet sociale, edukuese, policisë etj).⁵³

Nga ky kapitull mundemi të vijmë në përfundim se rol shumë i madh lidhur me Delikuencën e të Miturve kanë parimet bazë që e rregullojnë delikuencën e të miturve si dhe parimet që ju referohen të miturve, ku bëjnë pjesë parimet si parimi i ligjshmërisi si parim bazë dhe krucial për delikuencën, ku nënkuptojmë se një i mitur mundet të dënohet vetëm për atë vepër e cila parashihen në legjislacionin penal me normë të caktuar dhe sanksionimi të tillë.

⁵⁰ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, Rezoluta 45/113, 1990, pika 2

⁵¹ Direktivat e OKB për parandalimin e kriminalitetit të të miturve (Direktivat e Riadit), rezoluta 45/112, 1990

⁵² Konventa Evropiane për ushtrimin e të drejtave të fëmijës e Strasburgut, 1996

⁵³ Rezoluta e Këshillit të Ministrave të KE, 1978

Rëndësi pothujse të njetë sikurse parimi i ligjshmërisë ka edhe parimi i humanizimit, ku nënkuptojmë, sjelljen konformt rregullave dhe ligjeve në fuqi, ndalimin e sjelljeve poshtëruese, nënqmuere ndaj të miturit që ka kryer vepër penale, gjithashtu me këtë parimi nënkuptojmë rregullat strikte që duhet të respektohen ndaj kryersit ndalimin e dhunës ndaj tij dhe shumë faktorëve të ndryshëm ku folëm më lartë.

Parimi i cili është më i veçantë tek të miturit është parimi i interesit më të lartë të fëmijës, nga ky parim nënkuptojmë se fëmija apo i mituri duhet të trajtohet në mënyrë shumë të veçantë dhe duke respektuar ne maksimum të drejtat e tij.

Rregullimin e Delikuencës së të Miturve nuk e rregullojnë vetëm legjislacionet vendase përmes ligjeve lidhur me të miturit, por edhe Konvetat ndërkombëtare të cilat kanë një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për shtetet, për respektimin e të drejtave themelore të të miturve sikurse atyre që janë viktimë gjithashtu edhe të personave të mitur që kryejnë vetë vepra penale.

Kontribut kryesorë lidhur me të miturit ka dhënë Konventa mbi të drejtat e fëmijëve e miratuar nga asamblja e përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), më 20 Nëntorë, të vitit 1989. Rol pothuajse të njetë edhe pse e renditur e fundit kanë dhënë edhe shtetet Europiane, si dhe vetë Bashkimi European përmes rezolutave të ndryshme, siç është edhe Konventa Evropiane për ushtrimin e të drejtave të fëmijës e Strasburgut, 1996.

Kapitulli III

1. Profili i delikuentëve të mitur si kryers të veprave penale

Në kapitullin e tretë të këtij hulumtimi do të shtjellohen dhe elaborohen të dhëna dhe statistika të ndryshme lidhur me cilsitë personale të kryersve të veprave penale të cilët janë të mitur, ku do të elaborojmë konkretisht kryersit e mitur në aspekt se qfarë moshe paraqiten më së shpeshti kryersit e veprave penale dhe cila moshë kryen cilin krim, trajtimin e kryersve edhe në bazë të gjinis së tyre se kush kryen kriminalitet më të madh femrat apo meshkujt, konkretisht do të shtjellojmë se qfarë kriminalitetit kryejn më së shpeshti femrat e qfarë meshkujt, gjendja ekonomike e tyre a është faktorë dhe sa ndikon ajo për shtimin e kriminalitetit tek të mitur, dhe kejt në fund do të trajtojmë nacionalitetet e të miturve, ku jemi në dijeni se Republika e Kosovës përbëhet nga disa nacionalitete të ndryshme siç janë: Shqiptarët, Serbët, TURQIT, Romët, Ashkalinët, Boshnjakët, dhe pakicat e tjera.

1.1 Mosha

Përsa i përket ndarjes së të miturve në grup mosha, legjislacionet e vendeve të ndryshme e kanë të rregulluara në mënyra të ndryshme dhe jo të njetë, parashohin mosha të ndryshme të pjesëmarrësve në aktet kriminale.⁵⁴

Studiuesit përpiqen të shpjegojnë shkaqet e ndryshueshmërisë së krimit në varësi të moshës së tyre.

Ata e vëjnë theksin në faktorë të ndryshëm përbërja demografike e popullsisë, rëndësia që ka grup mosha e re në shoqëri, aktiviteti i madh i këtyre moshave, mënyra e kalimit të kohës së lirë, kontaktet e shumta me njërin tjetrin etj.⁵⁵

Sipas hulumtimeve Kriminologjike, duke u bazuar në librin e Profesor Ragip Halili-Kriminologjia, tregohet se të fëmijët dhe të miturit marin pjesë në 45,7% të rasteve të paraqitura për krime. Pjesëmarrja e tyre në disa vepra penale është më e madhe psh: te krimet e vjedhjeve të zakonshme, vjedhjet e imta, vjedhjet nëpër shitore, vjedhjet e automobilave, ajo arrin deri në 50%.

Mosha më e madhe e këtyre kryersëve të këtyre krimeve sillet nga 20 deri 25 vjeç.⁵⁶

Sipas Agjensisë së Statistikave të Kosovës (ASK), vetëm gjatë viti 2013 kemi pasur, 1412

⁵⁴ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 114

⁵⁵ Po aty, faqe 115

⁵⁶ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, faqe 226

aktakuza ndaj të miturve, kurse aktgjykime denuese po në këtë vit kemi pasur 40 aktgjykime dënuese, 122 Aktvendime Masë Disiplinore, 546 Aktvendime Masa e mbikshyrje së Shtuar, 44 Aktvendime Masa e Enteve, 34 Aktvendime urdhër për punë në dobi të përgjithsme, 42 Aktvendime Pezulluese dhe 584 mënyra të tjera të zgjidhjes së aktakuzës.⁵⁷

Kurse në Gjykatën themelore në Gjilan ku kompetenca edhe për teritorin e Komunës së Kamenicës dhe Vitit kemi 199 aktakuza ndaj të miturve vetëm në vitin 2013.⁵⁸

Sa i përket moshës të dhënat nga Enti statistikor Republikan i Maqedonisë së Veriut tregojnë se të miturit kryejn vepra penale më së shumti veprën penale kundër pasurisë, dhe mosha kryesisht e tyre është nga 14 deri në 18 vjeç.⁵⁹

Mosha përcaktohet në bazë të një vlersimi të plotë të të informacionit të disponueshëm, duke i dhënë rëndësinë e duhur çdo dokumenti zyrtar, të tillë si certifikata e lindjes, të dhënat e shkollës, të dhënat shëndetsore, deklarata e prindit për moshën e fëmijës dhe mënyra të ndryshme institucionale.

Nësa mosha e të miturit nuk është e përcaktuar në mënyrë të saktë, për marrjen e vendimit mbi përgjegjësinë penale do të konsiderohet mosha më e ulët, më e re.⁶⁰

Në vijim është paraqitur tabela ku praqiten Personat e mitur të dënuar sipas Gjykatave Themelore, llojit të dënimit dhe masave të shqiptuara. Ku shohim se në Gjykatën Themelore në Gjilan janë gjithsej 150 të dënuar, ku 98 janë të dënuar me masën masat e mbikshyrjes, 11 masa e enteve, 37 qortime gjygjësore, dhe me numër më të vogël me nga një masë janë shqiptuar, denim me gjobë 1, burgim me 5 deri 10 vjet një person, dhe masë disiplinore dy persona.

Kurse në tërë Republikën e Kosovës gjatë vitit 2018 kemi gjithsej 713 persona të dënuar, ku 10 persona janë të dënuar me gjobë, 23 persona të dënuar me burgim nga 2-6 muaj, 21 persona të dënuar nga 6-12 muaj denim me burg, 400 veta I janë shqiptuar masa e mbikshyrjes, kurse 107 persona janë shqiptuar qortim me gjobë dhe 38 persona të dënuar me punë në dobi të përgjithsme. Kurse më në detaje rreth shifrave të vitit 2018 të numrit të personave të dënuar në Gjykatat Themelore të Kosovës shohim tabelën numër një.

⁵⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), 2013

⁵⁸ Gjykata Themelore Gjilan, Statistikat 2013

⁵⁹ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 117

⁶⁰ Po aty

Tabela 1:

Numri rendor	Emri i Gjykatave	Numri i të dënuarve	Lloji i dënimit														
			Me gjobë	5-30 Ditë	1-2 Muaj	2 - 6 Muaj	6- 12 Muaj	1- 2 Vjet	2 - 5 Vjet	5 - 10 Vjet	Masat disiplinore	Masat e mbikëqyrjes	Masat e Enteve	Qortim Gjyqësor	Dërgimi në qendër	Detyrimet e veçanta	Punë në doli te
1	Gjykata Themelore Gjilan	150	1	-	-	-	-	-	-	1	2	98	11	37	-	-	-
2	Gjykata Themelore Prizren	79	-	-	-	-	-	-	-	1	16	31	17	10	2	-	2
3	Gjykata Themelore Pejë	32	-	-	-	-	1	-	-	-	-	27	2	-	-	-	2
4	Gjykata Themelore Gjakovë	36	-	-	-	-	-	-	-	-	1	27	6	-	1	-	1
5	Gjykata Themelore Prishtinë	250	9	1	1	23	16	10	7	3	6	10 4	10	52	1	1	6
6	Gjykata Themelore Ferizaj	133	-	-	-	-	-	-	-	-	3	10 3	2	-	-	-	25
7	Gjykata Themelore Mitrovicë	33	-	-	-	-	4	2	2	1	4	10	-	8	-	-	2
Gj i t h s e j:		713	10	1	1	23	21	12	9	6	32	40 0	48	107	4	1	38
%			1,4	0,1	0,1	3,2	2,9	1,7	1,3	0,8	4,5	56, 1	6,7	15, 0	0,6	0,1	5,3

61

⁶¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), 2013

1.2. Gjinia e kryesëve të veprave penale

Karakteristikë tepër interesante dhe e veçantë është edhe gjinia e kryesve të veprave penale, automatikisht kur filtret për krim na shkon mendja vetëm se kryes janë meshkujt, por kohët e fundit është shtuar jashtëzakonisht numri i femrave si kryes të veprave penale, ku kanë filluar edhe studime të ndryshme si shembull: femra dhe krimi ose analizimin e faktorëve që i shtojnë femrat drejt krimit etj.

Karakteristikë e delikuencës së të miturve është me kriminalitet merren si meshkujt ashtu edhe femrat. Shënimet statistikore të cilat do ti shohim si në vijim, tregojë se edhe femrat zhvillojnë veprimtari kriminale të ndryshme siç është marrja me prostitucion, bixhozi, vjedhje të imta, mashtrimi, dhuna në familje, kurse më pak kryejn vepra penale siç është kontrabanda me drogë, pjesëmarrja në rrahje, veprat penale kundër pasurisë, vrasja etj.

Duke u bazuar në statistikat e Agjencisë Statistike të Kosovës, shohim se numri i të dënuarve në bazë të gjinisë numri i femrave është shumë i vogël për dallim nga meshkujt por shohim edhe një rritje të krimeve të femrave nga viti në vit.

Në vitin 2003 në tërë Kosovën kanë qenë të dënuar 288 të mitur, 284 meshkuj dhe 4 femra, në vitin 2004, 338 nga ta 326 meshkuj dhe 12 femra, në vitin 2006, të dënuar 665, nga ta 647 meshkuj dhe 18 femra, në vitin 2012, të dënuar 474, meshkuj 463 kurse femra 11, viti 2013 numër mjaft i lartë i krimeve nga të miturit 786, ku 769 janë meshkuj kurse 17 prej tyre femra që kanë kryer vepra penale.⁶²

Nga këto analiza shohim se Çdo vit është në rritje kriminaliteti i të miturve në përgjithësi si dhe tek femrat është i shtuar mjaft shumë nga viti në vit.

Në vitin 2013 të përkthyer në përqindje se sa persona janë të dënuar meshkuj dhe sa femra shohim se 98,1% janë meshkuj, ndërsa 1,9% janë femra të dënuara.

Numri i personave të mitur të akuzuar në Gjykatat Themelore sipas gjinisë në vitin 2013 është ky: Gjykata Themelore Gjilan 195 meshkuj, 4 femra, Gjykata themelore Prizren 369 meshkuj, 9 femra, Gjykata themelore Pejë 62 meshkuj, 0 femra, Gjykata Themelore Gjakovë 229 meshkuj, 6 femra, Gjykata Themelore Prishtinë 409 meshkuj, 8 femra, Gjykata Themelore Ferizaj 121 meshkuj, asnjë femër.⁶³

⁶² Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK), 2003 - 2013

⁶³ Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK), Gjykatave Themelore 2013

Në vijim janë të dhënat statistikore të paraqitura ne formë tabelare, të dhëna të marrura nga Agjensioni statistikorë i Kosovës.

Paraqtija e tabelës si më poshtë tregon se si janë të denuar Personat e Mitur sipas gjinisë vështruar sipas viteve 2003-2013, si dhe numrin e të dënuarve mbrenda një viti, duke analizuar periudhën kohore 2003-2013. Në këtë table shohim se në vitin 2003 kemi pasur 288 të dënuar ku 284 meshkuj, dhe 4 femra, në vitin 2004 gjithsej 338 të dënuar, 326 meshkuj, 12 femra, në vitin 2008 kemi 719 të dënuar ku nga numri i përgjithshëm I të dënuarve 706 persona janë meshkuj dhe 13 femra.

Ndërsa dy vitet e fundit e paraqitur në tabelë është viti 2012-2013, ku në vitin 2012 kemi 474 persona të dënuar, 463 meshkuj dhe 11 persona të gjinisë femrore, ndërsa në vitin 2013 kemi 786 të dënuar, 769 meshkuj dhe 17 femra, diferenca midis viteve 2012-2013 është 312 të dënuar prej tyre 306 meshkuj dhe 6 femra.⁶⁴

Tabela: 2

Viti	Numri i të dënuarve	Gjinia e të dënuarve	
		Meshkuj	Femra
Viti-2003	288	284	4
Viti-2004	338	326	12
Viti-2005	229	224	5
Viti-2006	665	647	18
Viti-2007	648	637	11
Viti-2008	719	706	13
Viti-2009	686	637	13
Viti-2010	339	329	9
Viti-2011	375	366	9
Viti-2012	474	463	11
Viti-2013	786	769	17
Diferenca : 2013- 2012	312	306	6

⁶⁴ Agjencioni I Statistikave të Kosovës (ASK), Gjykatave Themelore, 2013

Në vijim është paraqitur të dhënat e Personave të mitur të dënuar në Gjykatat Themelore sipas viteve 2003/2018, si dhe dallimi midis gjinisë mashkuj femra sa janë të denuar. Tabela është vazhdimi i tabelës më lartë mirpo këtu janë të përfshirë edhe të dhënat nga viti 2013-2018, ku shohim se në vitin 2014 kemi 786 të dënuar, 826 meshkuj dhe 14 femra të dënuara, viti 2015 kemi një ulje të numrit të personave të dënuar për dallim nga viti 2014, në vitin 2015 kemi gjithsej 563 të dënuar, 548 meshkuj, 15 femra.⁶⁵

Tabela: 3

V i t i	Numri i të dënuarve	Gjinia e të dënuarve	
		Meshkuj	Femra
2003	288	284	4
2004	338	326	12
2005	229	224	5
2006	665	647	18
2007	648	637	11
2008	719	706	13
2009	686	673	13
2010	339	329	10
2011	375	366	9
2012	474	463	11
2013	786	769	17
2014	840	826	14
2015	563	548	15
2016	692	666	26
2017	766	726	40
2018	713	680	33
Diferenca : 2018 – 2017	-53	-46	-7

⁶⁵ Agjencioni I Statistikave të Kosovës (ASK), Gjykatave Themelore 2003-2018

Gjendja ekonomike

Sipas shumë hulumtuesve shkencorë, kushtet materiale ekonomike janë një nga faktorët më vendimtarë për shfaqjen e delikuencës së të miturve. Këtu bëjnë pjesë varfëria, papunësia, krizat ekonomike etj. Kushtet e vështira materiale konsiderohen si një faktor objektiv që ndikon në delikuencën dhe sjelljet kriminale të të rinjve. Në literaturën sociologjike dhe kriminologjike bëhet fjalë për ndikimin e madh që kanë kushtet e rënda materiale dhe varfëria në delikuencën e të miturve. Filozofi i madh antik Aristoteli thoshte që varfëria është nëna e krimit, kurse begatia nëna e amoralitetit.⁶⁶

Në periudhën e pasluftës, gjë që vihet re dhe në periudhën 2005-2010, periudhë e cila është marrë në studim, në Kosovë vërehet shtimi i disa sjelljeve kriminale e delikuede si rezultat i varfërisë, skamjes dhe kushteve të vështira pas luftës. Format më të shpeshta të sjelljeve kriminale të cilat kryhen për shkak të varfërisë dhe kushteve të vështira materiale janë vjedhjet e vogla, grabitjet, mashtrimet, dhënia pas bredhjes, lëmoshës, prostitucionit dhe alkoolizmit.⁶⁷

Varfëria në Kosovë, e trashëguar nga e kaluara, e thelluar edhe më shumë pas luftës (1999), ka dalë faktori më me ndikim në shkaktimin e delikuencës së të miturve. Nga të dhënat e RIINVEST dhe të Bankës Botërore, në vitin 2005, Kosova kishte rreth 2 milionë e gjysmë banorë me shkallën e papunësisë prej 52 për qind dhe me një varfëri ekstreme prej 12 për qind.⁶⁸

Këto të dhëna flasin qartë për pozitën e vështirë materiale të qytetarëve të Kosovës në vitet 2005- 2010, e cila drejtpërdrejtë ose tërthorazi i shtyu të miturit që, për plotësimin e nevojave materiale (nganjëherë të domosdoshme) të kryejnë vepra kriminale, mashtrime, vjedhje etj., për të përfunduar si të denoncuar: delinkuentë të mitur.

Kushtet ekonomike të zhvillimit të shoqërisë, kriza ekonomike dhe problemet e tjera ekonomike, statusi material dhe dallimet në pozita ekonomike të kategorive të veçanta të popullsisë janë shumë të rëndësishme dhe na bëjnë të kuptojmë shkaqet e paraqitjes së sjelljes delikuede tek të rinjtë. Disa kërkime tregojnë se, me rastin e paraqitjes së krizës ekonomike dhe pasigurisë ekonomike të qytetarëve, kriminaliteti rritet në forma të ndryshme. Kriza ekonomike karakterizohet me papunësi, parregullsi ekonomike, zvogëlim të të ardhurave personale dhe ulje të standardit të qytetarëve. Kriza ekonomike, sidomos që vjen si pasojë e

⁶⁶ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2016, faqe 241

⁶⁷ (Po aty)

⁶⁸ World Bank, 2005

gjendjes së pasluftës, shoqërohet nga një lloj shtresëzimit të popullsisë ku një kategori (e vogël) individësh janë në skajet e larta nga një lloj pasurimi kriminal, ndërsa pjesa më e madhe paraqitet e varfër.⁶⁹

Kriza ekonomike mundëson paraqitjen e dukurive të krizës familjare depresionit, alkoolizmit, vjedhjes dhe mashtrimit, si tek të rinjtë ashtu edhe tek të moshuarit. Pasojat e varfërisë janë jo- arsimimi, jo-kualifikimi, papunësia dhe të hyrat jo të mjaftueshme të cilat shprehen negativisht në statusin familjar, jo vetëm atë ekonomik por edhe në atë asocial dhe kulturor.

Varfëria përfaqëson njërin prej faktorëve kryesor të kësaj dukurie tek delikuentet e mitur. Varfëria manifestohet në mënyra të ndryshme në mes të të cilave është mungesa e të hyrave, mungesa e mjeteve, mungesa e sigurimit të ekzistencës, uria, shëndeti i lig, qasje e kufizuar apo kurrfarë në arsim dhe shërbime tjera bazike, rritja e numrit të vdekshmërisë duke përfshirë këtu edhe vdekjet nga sëmundjet, mos-strehimi dhe kushtet jo të mira banesore, rrethi jo-i sigurt, diskriminimi i shoqërisë dhe izolimi (të gjitha të përmendurat jo rrallë ndihmojnë në paraqitjen e sjelljeve delikuede tek të rinjtë).⁷⁰

Faktor i rëndësishëm ekonomik në realitetin kosovar, i cili shpesh është shkaktar i sjelljes delikuede është papunësia. Shumë hulumtime tregojnë se deliktet në pasuri dhe delikueda e të miturve paraqitet për shkak të papunësisë. Pasojat e papunësisë mund të jenë në forma të ndryshme për shkak të devijimit social, siç është alkoolizmi, bredhja, kërkim lëmoshe dhe të ngjashme.

Në delikuedën e të miturve bëjnë pjesë edhe ata fëmijë të cilët posedojnë gjithçka që dëshirojnë në familje. Ata janë më të rrezikshëm, janë të papërmbytur, mbajnë me vete armë zjarri, nuk hezitojnë përdorimin e tyre, nuk përdorin llojet e drogave ‘sociale’ por përdorin drogat më të ‘forta’, derisa familja është në gjendje që, përmes parasë të plotësojë çdo dëshirë të tyre në mënyrë që atyre fëmijëve mos tu mungojë asgjë. Përderisa fëmijët e familjeve të varfra gjithmonë kanë frikën se mos po i heton ndokush, ndërsa fëmijët e të pasurve nuk i frikohen askujt, bëjnë vepra të tilla publikisht sepse në të vërtetë këta fëmijë e kanë ‘shpinën e fortë’.⁷¹

Situata e krijuar pas luftës në realitetin kosovar i nxiti fëmijët në mënyrë të pavetëdijshme dhe kundër dëshirës dhe edukatës familjare, të provonin rreziqet e daljes në treg për të punuar si shitës të cigareve, bartjes së sendeve me karroca hamalli etj.

Paslufta është shoqëruar me varfëri të skajshme dhe të rinjtë, në pamundësi për t’i arritur

⁶⁹ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2016, faqe 246

⁷⁰ (Po aty)

⁷¹ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2016, faqe 251,

qëllimet e tyre në mënyrën e duhur, zgjedhin alternativa devijante dhe të papranueshme nga shoqëria, Duket se teoria e Robert Merton në lidhje me anominë duket se aktualizohet në kontekstin kosovar në lidhje me delikuencën e të miturve.

Kemi paraqitur edhe Shkallën e varfërisë dhe shpërndarja e të varfërve sipas nivelit më të lartë të arsimit të mbaruar (15 vjeç e më shumë) nga periudha 2012-2017, si në vijim.⁷²

Tabela: 4


	Shkalla e varfërisë (%)						Shpërndarja e të varfërve (%)					Shpërndarja e popullsisë (%)						
Viti	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Nuk e mbaroi shkollën fillore	37.0	21.2	30.1	22.8	27.4	21.5	17.8	12.8	17.0	14.2	5.2	3.9	10.8	10.2	11.1	10.3	3.0	3.1
Fillore	25.2	20.0	22.0	18.7	20.0	21.6	45.7	46.6	41.7	40.5	53.1	51.6	40.9	39.3	37.2	35.7	42.2	40.0
Të mesmen ose profesionale	19.0	15.6	17.3	15.7	14.3	15.4	33.7	37.3	36.6	41.0	39.0	40.2	40.0	40.3	41.6	43.3	43.4	43.9
Universitet	7.6	5.6	9.0	6.6	3.9	5.5	2.8	3.4	4.7	4.2	2.8	4.3	8.3	10.2	10.1	10.7	11.3	13.0
Gjithsej	22.5	16.9	19.6	16.5	15.9	16.8	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Ne vijim do të shohim Shkallën e varfërisë së skajshme sipas vendbanimit për popullsinë e përgjithshme dhe fëmijët 0-18 vjeç (%) të periudhës 2012-2017, të marrur nga agjensioni i statistikave të Kosovës. Në

⁷² Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Shkalla e varfërisë dhe arsimimit, 2012-2017

gragikon e pare shohim vitin 2012 ku në zonat urbane shkalla e varfërisë është në përqindjen e 7.1%, për dallim nga zona rurale ku viti I njetë shkalla e varfërisë është 8.3%, viti tjetër I paraqitur 2013 shohim se kemi 5.3% dhe 6.0% në zonat rurale, nga grafikoni I më poshtëm vërejmë se në qdo vit shkalla e varfërisë së skajshme dominon më së shumti në zonat rurale se sa ato urbane. Edhe tek fëmijët është I njeti trend ku shkalla e varfërisë së skajshme është më e butë në zonat urbane ku shihet se në vitin 2017 ne zone urbane shkalla e varfërisë nën moshën 18 vjeç është 6.7% ndërsa në zonën rurale pot ë këtij viti kemi 7.2%.⁷³

Grafikoni :1



3. Nacionaliteti

Kriminaliteti pra është prezentë në të gjithë portet e shoqërisë dhe pothuajse i prek të gjitha shtresat e saj, nga analizimi shohim se kriminalitet nga të miturit kryejn pa dallim gjini moshe feje dhe faktore tjetër.

Kriminaliteti është i përhapur edhe tek të miturit që janë me shkollim të lartë, si dhe të miturit që rrjedhin nga familje të shkolluara dhe të rangut më të lartë.

Në Republikën e Kosovë siç e dimë është shtet multietnik, ku gërshetohet nacionalitete të ndryshme, kultura dhe tradita laramane, por gjatë elaborimit të statistikave se cilat nacionalitete kryejnë krime nga të miturit shohim se të gjitha janë të prekura nga kjo dukuri, pra nga delikuenca e të miturve, normalisht numri më i madh është për nacionalitet Shqiptarë vetëm për një arsye të thjeshtë se e përbëjnë mbi 90 % popullsisë Shiptare.

Për saktësin e këtij hulumtime, kemi elaboruar të dhënat statistikore nga Agjensioni i

⁷³ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),

Statistikave të Kosovës (ASK), ku e kemi marrë një periudhë të caktuar kohore,periudhën një vjeqare nga 1 Janari i vitit 2013 deri më 31 Dhjetore të po këtij viti, ku kemi analizuar se cili nacionalitet kryen më së shumti Vepra penale për të mitur gjatë kësaj periudhe të caktuar kohore, ndarja e kryesve të veprave penale sipas nacionalitet dhe Gjykatave themelore, si dhe ndarjen e personave të mitur sipas llojit të veprës penale dhe përkatësi nacionale.

Sipas Agjensis për Statistika të Kosovës (ASK), në vitin 2013 kemi pasur 1412 aktakuza për të miturit, ku prej tyre 1373 Shqiptar, 21 Serb, 7 Malazez, 6 Romë, 3 boshnjak dhe 2 të tjerë.

Në Gjykatën Themelore të Gjilanit në vitin 2013 kemi pasur 199 aktakuza për të mitur që janë trajtuar po në këtë gjykatë në departamentin për të mitur, ku 193 prej tyre kanë qenë Shqiptar dhe 6 Serb,kurse në Gjykatën Themelore Prizren,departamenin për të mitur kemi pasur 378 aktakuza ku 364 Shqiptar, dhe 7 të nacionalitetit Turk.⁷⁴

Ndëra në Gjykatën Themelore Prishtinë kemi 412 Shqiptar dhe 5 Serb,Gjykata Themelore Ferizaj 109 Shqiptar, 10 Serb dhe 2 të tjerë.

Të përkthjara në përqindje shohim se Nacionaliteti Shqipatrë gjat vitit 2013 ka kryer me së shumti vepra penale nga të miturit 96,8 %, i ndjekur nga Serbët me 2,3%, Turqit me 0,5%, dhe të tjerët me 0,4%.⁷⁵

Kurse të dënuar e mitur sipas vepra penale dhe nacionalitet kemi marur si elaborim vetëm 3 lloje të veprave penale se sa janë të denuar sipas nacionalitetetve.

Vepra penale Lëndim i lehtë trupor 153-23 KPK, kemi 188 të dënuar gjithsej në vitin 2013 ku 186 janë Shqiptar, 1 Serb, 1 Turk.

Në Veprën Penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare 305 KPK, në vitin 2013 kemi 3 persona të dënuar 1 Shqiptar dhe 2 Turq.

Në Veprën Penale Vjedhja sipas KPK-252, kemi 68 të dënuaar, ku 65 prej tyre të nacionalitet Shqiptar dhe 3 Serb.⁷⁶

Në tabelën e më poshtme kemi paraqitur Numri i personave të mitur të dënuar në Gjykatat Themeloret sipas gjinisë dhe nacionalitetit, në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës të vitit 2013. Ku shohim se në Gjykatën Themelore Gjilan kemi 103 të dënuar ku 100 prej tyre të nacionalitetit Shqiptarë dhe 3 Serb. Gjykata Themelore

⁷⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), të Gjykatave Themelore, 2013

⁷⁵ Po aty

⁷⁶ Po aty

Prizren 118 të dënuar, 113 Shqiptar dhe 4 Turq. Numri I përgjithshëm në vitin 2013 të të dënuarve është 786, 761 Shqiptarë, 18 Serb, dhe 4 Turq.⁷⁷


Tabela:5

Numri rendor	Emri i Gjykatave	Numri i të dënuarve		Gjinia e të dënuarve			Nacionaliteti i të dënuarve							
		Nr.	%	Meshkuj	Femra	Shqiptar	Serb	Malazez	Boshnjak	Goran	Turq	Rom. Egjipt as Ashkali	Të huaj	Të tjerë
1	Gjykata Themelore Gjilan	103	13,1	100	3	100	3	-	-	-	-	-	-	-
2	Gjykata Themelore Prizren	118	15,0	114	4	113	1	-	-	-	4	-	-	-
3	Gjykata Themelore Pejë	43	5,5	43	-	42	-	-	-	-	-	-	-	1
4	Gjykata Themelore Gjakovë	111	14,1	108	3	111	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Gjykata Themelore Prishtinë	317	40,3	310	7	312	5	-	-	-	-	-	-	-
6	Gjykata Themelore Ferizaj	94	12,0	94	-	83	9	-	-	-	-	-	-	2
7	Gjykata Themelore Mitrovicë	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Gjithsej: Gjykatat Themelore		786	100	769	17	761	18	0	0	0	4	0	0	3
%				97,8	2,2	96,8	2,3	0,0	0,0	0,0	0,5	0,0	0,0	0,4

Grafikoni si më poshtë ka të paraqitur numrin e të miturve të dënuar në Gjykatat Themelore sipas gjinisë, nacionalitetit në përqindje, e përkthyer në përqindje shohim se 96.8 % të të dënuarve janë Shqiptarë, 2.3 % Serb, 0,5 Turq dhe 0.4 të tjerë.⁷⁸

⁷⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), numri I të dënuarve sipas Nacionalitetit dhe Gjinisë, 2013

⁷⁸ Po aty

Grafikoni: 2

Ne vijim keni Numrin e personave të mitur të akuzuar në Gjykatat Themelore sipas nacionalitetit gjatë vitit 2018 ku shohim se në Gjykatë Themelore Gjilan kemi 218 të dënuar ku vetë 3 janë Serb, Gjykata Themelore Prishtinë 389 të dënuar, 382 Shqiptar, 6 Serb, 1 të huaj, Gjykata Themelore Pejë, 36 të dënuar vetëm një person i nacionalitetit Serb. Gjithsej mbrenda vitit 2018 kemi 1179 të dënuar, 1148 Shqiptarë, 21 Serb, 5 Turq, 1 të huaj dhe 4 të tjerë.⁷⁹

Tabela:6

NR.	Emri i Gjykatave	Numri i të akuzuarve sipas Nacionaliteti i të akuzuarve						
		Nr.	%	Shqiptar	Serb	Turq	Të huaj	Të tjerë
1	Gjykata Themelore Gjilan	218	18,5	213	3	-	-	-
2	Gjykata Themelore Prizren	170	14,4	162	-	5	-	3
3	Gjykata Themelore Pejë	36	3,1	35	1	-	-	-
4	Gjykata Themelore Gjakovë	49	4,2	49	-	-	-	-
5	Gjykata Themelore Prishtinë	389	33,0	382	6	-	1	-
6	Gjykata Themelore Ferizaj	264	22,4	262	2	-	-	-
7	Gjykata Themelore Mitrovicë	53	4,5	45	7	-	-	1
Gj i t h s e j:		1.179	100,0	1.148	21	5	1	4

⁷⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), numri i të dënuarve sipas Nacionalitetit ,2013

Kapitulli IV

1. Parandalimi i kryerjes së veprave penale nga ana e të miturve

Termi prevecion (parandalim), është huazuar në mënyrë pragmatike nga evokabulari dhe fjalori i praktikës mjeksore. Në kuptimin e vetë të gjerë janë profilizuar dy përmbatje themelore të këtij nocioni, i pari prej tyre ka të bëjë me intervenimin si formë primare, kurse forma e dytë ka të bëjë me reaksioni dhe reagimin para se të jetë manifestuar dukuria kriminale e padëshiruar për shoqërinë.

Në gjuhën latine, *praeventio* (*prae-venio*, ventim *paraeventus*, *praevenire*) shënon përcaktimin dhe termin e kaloj, arrijë përpara, e kapërcej një dukuri të caktuar, ose siç do të mund të thuhet në bazë të mendjes së shëndoshë parandalim, mbrotje paraprake, pengim, shmangie që më parë.

Nocion parandalim përmban në vete të gjitha masat e ndërmara në mënyrë të planifikuara, të paramenduara dhe të organizuara me të cilat do të bëhet përpjekje të menjahen ose të zvoglohet shkaqet e drjtëpërdrejta dhe të sjelljeve kriminale dhe sjelljeve të dënueshme.⁸⁰

Qëllimi i parandalimit të kriminalitetit është pengimi i një vargu të tërë të veprimeve të ndryshme kriminale siç janë deliktet pasurore, deliktet me narkotikët, deliktet e dhunës, deliktet e kriminalitetit të organizuar, që janë të përhapura shumë ditëve të sotme.

Në të gjitha fazat e veprimtarisë kriminale aplikohet me sukses instituti i parandalimit, qëllimi kryesor i të cilit është pengimi i ardhjes së pasojës kriminale, si dhe evidentimi me anë të gjurmimit dhe të investigimit të qëllimeve, motiveve dhe lidhjeve të kontingjenteve kriminale kudo ku ata janë, pavarësisht nga statusi që ata kanë, duke organizuar me sukses përsëri parandalimin, i cili duhet të jetë prezent në të gjithë veprimtarinë e bashkërenduar të institucioneve të specializuara të shtetit, duke bashkëpunuar me OJQ-ët, komunitetet, Mas-mediat etj.⁸¹

Emergjente në kushtet e sotme është parandalimi i veprimtarisë kriminale të adoleshentëve dhe të rinjëve. Pikësëpari analizën duhet t'a fillojmë nga "veprimtaria parakriminale" e këtyre të rinjëve, duke parë me kujdes çështjet individuale dhe kolektive të tyre, të lidhur këto me mjedisin ku ata jetojnë, punojnë apo mësojnë dhe me siguri do të nxjerrim rolin e funksionin e faktorëve që determinojnë në futjen e tyre në veprimtari kriminale, duke filluar qysh nga: familja, shkolla, mjedisi shoqëror, vendi i punës, koha e lirë, roli dhe funksioni sidomos i

⁸⁰ V. Latifi, Politika Kriminale, Prishtinë, 2013, faqe 179

⁸¹ (Po aty), faqe 183

medias elektronike etj.

Dhe më vonë të dalim tek roli dhe funksioni i institucioneve të specializuara, OJQ-ëve etj, në parandalimin e veprimtarisë kriminale të këtyre të rinjëve, duke bërë të mundur largimin sa më shumë nga radhët e tyre nga rruga e krimit ordiner dhe atij të organizuar.

Në fakt ky është aktualisht një problem jo vetëm i shteteve në tranzicion siç është Republika e Kosovës, por edhe i shumë shteteve të tjera, të cilët përballen vazhdimisht, kërkojnë rrugë dhe mundësi për t'i kapërxyer, duke vënë në lëvizje dhe vullnetarë nga komunitetet, me emërtime të ndryshme si psh grupe: të vetmbrojtjes qytetare, të shpëtimit publik, të sigurimit të rendit dhe të qetësisë publike etj.

Dhe sa herë ndodhen para probleme të vështira për t'i zgjidhur i drejtohen komuniteteve për t'i ndihmuar, të cilët janë më të azhurnuar me aktivitetet "parakriminale" të mjaft të rinjëve në mjediset ku ata banojnë, punojnë, apo atje ku sigurojnë mjetet e jetesës. Informacioni i larmishëm që do të dalë nga këto grupe, si dhe nga intervistat konfidenciale, do të jetë patjetër një mjet i rëndësishëm për një fillim të organizuar të veprimtarisë parandaluese të kontingjenteve që vinë nga radhët e adoleshentëve dhe të rinjëve.

Me parandalimin e kriminalitetit në praktikën e politikës kriminale bashkohore merren shumë organe shtetërore, institucione të ndryshme, ojq si dhe media dhe organizata ndërkombëtare. Në procesin e luftimit të kriminalitetit është jashtëzakonisht e rëndësishme të përcaktohen prerazi dhe kokretisht rolet, detyrat dhe qëllimet e subjekteve të caktuara të aktivitetit parandalues të kriminalitetit.⁸²

Kemi disa llojet të parandalimit shoqërorë të kriminalitetit, në literaturë kemi ndarje të ndryshme siç janë ndarja në primare, sekondare, terciare.

Prevecioni parësor ndërlidhet me krijimin e kushteve në mikromjedisin i cili vepron rezistueshëm në raport me kriminalitetin dhe devijimin.

Prevecioni sekondarë ka të bëjë me aplikimin e masave shoqërore ndaj kryesve potencial, kurse prevecioni terciar ka të bëjë me procedimin ndaj individëve, me qëllim të parandalimit të tyre që të mos kryejnë sërish veprime të inkriminuara dhe të mos bëhen recidivistë.

Përcaktimi kuptimor i prevecionit të përgjithshëm shoqërorë kërkon marrjen e masave të ndryshme, me ndihmën e të cilave ndryshojnë kushtet shoqërore të jetës, zhvillohet fuqia e brendshme e shoqërisë dhe ngritet shkalla e saj kulturore, sociale dhe etike, zhvillohet vetëdija për angazhimin e asocioneve dhe institucioneve shoqërore.⁸³

Për nga karakteri i tyre, masat e prevecionit të përgjithshëm social janë të ndryshme. Ato

⁸² V. Latifi, Politika Kriminale, Prishtinë, 2013, faqe 186

⁸³ Po aty

dalohen nga përmbatja si dhe nga ndikimi. Si të tilla, ato janë të shumta si ekonomike, sociale, politike, kulturore, edukative etj.

Disa autorë, duke trajtuar parandalimin e përgjithshëm kriminal e social, masat e këtij prevencioni i ka ndarë në gjashtë grupe kryesore të posaçme, siç janë: ekonomike, socialo-politike, juridiko-shtetërore, soci-psikologjike, kulturore-edukative, sociale.⁸⁴

Republika e Kosovës si masë parandaluese për kriminalitetin tek të miturit dhe në përgjithëse ka hartuar Strategjinë Shtetërore të Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit, si dhe ka hartuar Planin e veprimit 2009-2012.

Objektivat strategjike të kësaj strategjie, synojnë të sigurojnë përgjigje adekuate për parandalimin e krimit si dhe përfshijnë:

1. Parandalimin e krimit përmes zhvillimit të sistemit të hershëm të intervenimit-reagimit,
2. Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës ligjore,
3. Avancimi i kapaciteteve institucionale me qëllim të parandalimit të krimit,
4. Zhvillimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit dhe koordinimit,
5. Zhvillimi dhe zbatimi masave/shërbimeve sociale me qëllim të parandalimit të krimit.⁸⁵

Objektivat strategjike të cekura më lartë detajizohen tutje më poshtë:

1. Parandalimi i krimit përmes zhvillimit të sistemit të hershëm të intervenimit-reagimit
Parandalimi i krimit është koncept i cili duhet të zhvillohet në institucionet lokale, fillimisht në nivel të ulët, ku krimi kryesisht ka për cak bashkësinë. Komunitet dhe stacionet lokale të policisë, janë entitetet e para të cilat duhet të merren me problemin, prandaj fokusi në zhvillimin institucional duhet të vendoset në to. Për të parandaluar krimin është shumë me rëndësi që të ekzistojë një sistem i mbledhjes së të dhënave jo vetëm kuantitative por edhe atyre kualitative, për të identifikuar rastet potenciale për krim dhe që do të shërbejnë në analizat e institucioneve për zbatimin e ligjit rreth ndërmarrjes së masave që do të ndikojnë në parandalimin e krimit. Në këtë kontekst, është shumë me rëndësi që Kosova të avancojë sistemin me të dhëna kualitative për të kontribuar në: 1.1 Fuqizimin e strategjisë për siguri në shkollë; 1.2 Zhvillimin e sistemit/programit efikas dhe aktual të parandalimit të krimit. (Identifikimi shkaqeve, përcaktimi i prioriteteve, ngritja e vetëdijës, vlerësimi, modeli SARA); 1.3 Vlerësimi i trendëve dhe tendencave të krimit sipas metodologjisë së miratuar; 1.4. Ngritja e vetëdijës së institucioneve lokale për intervenimet/reagimet e mundshme për

⁸⁴ V. Latifi, Politika Kriminale, Prishtinë, 2013, faqe 188

⁸⁵ Strategjinë Shtetërore të Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit, si dhe Planin e veprimit 2009-2012.

parandalim të krimit, përmes përfshirjes së tyre në sistemin/programin e parandalimit të krimit; 1.5 Angazhimi i shoqërisë civile përmes përfshirjes së tyre në sistemin/programin e parandalimit të krimit.⁸⁶

2. Roli i Gjykatës në parandalimin e delikuençës së të miturve

Gjykatat janë organe shtetërore të pavarura të cilave u përket pushteti gjyqësor. Gjykatat mbrojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve, të drejtat e përcaktuara me ligj dhe interesat e subjekteve juridike dhe sigurojnë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Gjykatat në njërën anë realizojnë mbrojtjen e rolit sipas të drejtave të garantuara me ligj interesat dhe liritë e qytetarëve, në anën tjetër plotësojnë rolin e garantimit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë si themel i sundimit të ligjit. Në një numër të madh shtetesh normat themelore ligjore sipas dispozitave të cilave gjykatat veprojnë janë ligji penal/ndëshkimor (material) dhe ligji mbi procedurën penale/ndëshkimore. Aktgjykimi me të cilin në një masë të caktuar të gjykuarit i pezullohet njëra ndër të drejtat dhe liritë e garantuara, shpreh funksionin represiv të cilin e realizon gjykata. Megjithatë kjo masë represive ka edhe karakterin e saj preventiv sepse çdo sanksion i shqiptuar penal duhet të jetë në pajtim me qëllimin e paramenduar si ndaj kryesit ashtu edhe ndaj rrethit të ngushtë dhe të gjerë.⁸⁷

Dukuritë të cilat zvogëlojnë efektet dhe pjesëmarrja e gjykatave në luftimin e kriminalitetit Ndjeshmëria e çështjes për të cilën vendosin gjykatat mendohet para së gjithash në kufizimin apo pezullimin e disa të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë, duhet të jetë interes edhe i bashkësisë së gjerë në të cilën funksionon ajo.⁸⁸

Në efikasitetin apo joefikasitetin e punës së gjykatave ndikojnë një numër faktorësh dhe rrethanash ndër të cilat po përmendim ngarkimin e tepërt, zgjatja e procedurës gjyqësore, pavarësia në ushtrimin e pushtetit gjyqësor dhe efektet që rezultojnë nga dënimet e lehta apo të rënda të shqiptuara.

Stërngarkimi paraqet një dukuri negative që dukshëm zvogëlon efektet dhe pjesëmarrjen e gjykatave në luftimin e kriminalitetit. Zgjidhja e këtij problemi vështirë mund të shihet në rastet e shtimit të vazhdueshëm të numrit të gjyqtarëve dhe personelit tjetër, atë duhet kërkuar në përzgjedhjen e lëndëve penale (që duhet të arrihet si me zvogëlimin e numrit të inkriminimeve gjegjësisht ngushtimin e zonës kriminale të cilën e përfshijnë ato si dhe me

⁸⁶ Po aty

⁸⁷ I. Zejneli, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, faqe 68

⁸⁸ (Po aty)

rregullimin e kriterëve ligjore për selektimin dhe zbatimin e të drejtës penale) sikurse edhe në organizimin më të mirë të gjykatave.

Zgjatja e procedurës gjyqësore gjegjësisht vazhdimi i gjatë i procedurës së shkallës së parë është njëra ndër të metat themelore në punën e gjykatave.

Pavarësia në ushtrimin e pushtetit gjyqësor-mëvetësia. Gjykata duhet të jetë deri në fund e pavarur dhe autonome, e liruar nga “direktivat e politikës ditore dhe praktikizmi” si dhe nga presionet të cilat mund ta sjellin në pyetje ushtrimin e mirë të funksionit gjyqësor dhe ta shkatërrojnë autoritetin e gjykatës në popull.⁸⁹

Organet e drejtësisë në Kosovë tashmë kanë krijuar një përvojë fillestare për trajtimin profesional e ligjor të të miturve delinkuentë.

Trajtimi i delinkuentëve nga prokuroria dhe gjykata, që nga pranimi i kallëzimit penal në prokurori, bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit penal për të miturit në Kosovë dhe Kodit të procedurës penale, të cilët kërkojnë që të miturve t'u kushtohet vëmendje e posaçme, në mënyrë që të mos ndikojë negativisht në dinjitetin dhe personalitetin e tyre për shkak të moshës dhe gjendjes psikike delikate. Kur merret deklarata prej të miturit, atij i ofrohet mundësia që të shprehet lirisht dhe që ta realizojë të drejtën për ndihmë të menjëhershme ligjore, duke përfshirë praninë e prindit dhe të mbrojtësit. Në rastin kur vendoset dënimi me heqje të lirisë për shkak të veprës së kryer, të miturit i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike e, sipas nevojës, edhe ndihmë mjekësore për të lehtësuar rehabilitimin e tij.⁹⁰

Me rastin e caktimit të masës apo dënimit për të miturin, gjykata merr parasysh në radhë të parë interesin më të mirë të të miturit, si edhe llojin dhe peshën e veprës penale, moshën e të miturit, nivelin e zhvillimit psikologjik, karakterin, prirjet e motivet që e kanë nxitur për ta bërë atë vepër, mjedisin dhe rrethanat e jetës së tij, nëse ka qenë më parë i dënuar apo jo dhe rrethanat e tjera që mund të ndikojnë në shqiptimin e masës apo dënimit. Ndaj të miturit mund të merren masat e diversitetit dhe masat edukative. Për të miturin që nuk e ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare në kohën e kryerjes së veprës penale, mund të vetëm masa edukuese, ndërkohë që për ata mbi këtë moshë jepen këto dënime: gjoba, urdhri përpunë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të miturin.⁹¹

3. Roli i policisë në parandalimin e delikuenës së të miturve

Sistemet qeveritare për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve në konflikt me ligjin ndryshojnë

⁸⁹ V.Latifi, H. Demolli, Kriminalistika, Prishtinë 2019, faqe 95

⁹⁰ Kodi Nr. 06/L-006 I Drejtësisë për të Mitur

⁹¹ Po aty

në emër dhe qasje, në përputhje me rrethanat e vendit. Fëmijët mund të trajtohen nëpërmjet drejtësisë formale apo sistemit të gjykatave, nga sistemi i mbrojtjes sociale, apo për kundërvajtje të vogla nga një sistem administrativ. Sisteme të tilla mund të funksionojnë në kuadër të sistemit të drejtësisë penale për të rritur, ose mund të veprojnë kryesisht jashtë sistemit gjyqësor nëpërmjet komiteteve, komisioneve apo paneleve administrative.

Në të gjitha rastet kur sistemi përmban një shkallë të specializimit për fëmijët, qoftë kur sistemi është i bazuar në gjykata, sistemi i mbrojtjes sociale apo sistemi administrativ, ai njihet shpesh si një sistem i drejtësisë për të mitur. Në vendet që nuk kanë ndonjë shkallë specializimi të drejtësisë për fëmijë, fëmijët në konflikt me ligjin trajtohen në masë të madhe në të njëjtën mënyrë si të rriturit.

Ndër institucionet shtetërore në Kosovë, që merren me dukurinë e delinkuencës së të miturve, me identifikimin, trajtimin dhe shërbimin për parandalimin e tij është edhe Policia e Kosovës. Kontributi i këtij shërbimi ka shënuar rezultate të dukshme në punën me të mitur kundër sjelljeve asociale dhe kundër shkeljes së ligjit. Puna e punonjësve të Policisë së Kosovës në këtë dukuri, konstaton në kontaktin me të miturit, ndalimin e tyre, bisedën, marrjen e informatave për njohjen sa më të mirë të tyre. Përgjithësisht të miturit që përfshihen në veprimtari delinkuente janë individë në pozita shumë të vështira familjare, sociale, moshore, kulturore etj. dhe si rezultat veprimet e tyre shkojnë deri në vjedhje, përdorim të armëve të ftohta në zënka deri në situata pa rrugë-dalje për moshën e tyre, vrasje, tentativa të vrasjes, trafikim, konsumim të narkotikëve etj.⁹²

Prandaj kërkojnë një nivel të lartë profesionalizmi nga ana e punonjësve të policisë që merren me trajtimin fillestar të tyre.

Deri në vitin 2008 nuk ishte bërë kalimi i plotë i të gjitha njësive nga Policia e UNMIK-ut në Policinë e Kosovës, prandaj edhe u hasën mjaft vështirësi në gjetjen dhe mbledhjen e këtyre të dhënave. Nga statistikat vihet re se numri i të miturve të ndaluar nga policia e Kosovës përgjatë periudhës 2005-2010 është 40.330 të mitur, shifër kjo tepër e lartë krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës. Nga këta të mitur, pjesa më e madhe janë të kombësisë shqiptare (31.505 të mitur), por ka dhe mjaft të mitur të tjerë me kombësi serbe, rumune, boshnjake etj.⁹³

Pas ndalimit/arrestimit të të miturve që kryejnë kundravajtje penale, rastet trajtohen nga organet e drejtësisë.

⁹² Ligji Nr. 04/L-076, Për Policinë, 2012

⁹³ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Policia e Kosovës, 2005-2010

Policia e Kosovës pas pranimit të një informate për kryerjen e një veprë penale, heton për të zbuluar nëse ka dyshim të arsyeshëm se vepra e kryer ndiqet sipas detyrës zyrtare. Për të arritur këtë qëllim sipas dispozitave ligjore të Kodit të procedurës penale të Republikës së Kosovës, policia kryen hetime preliminare dhe ndërmerr të gjitha masat e nevojshme duke u mbështetur në autorizimet ligjore siç janë; mbledhja e informatave, kryerja kontrolleve, sigurimi i dëshmive etj. Posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare brenda njëzet e katër orëve policia përpilon raport dhe ia drejton prokurorit kompetent të shtetit i cili vendos nëse duhet hapur procedura penale apo jo.⁹⁴

Kurse sipas Ligjit për Procedurë Penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut (LPP), parasheh se në nenet (46, 48-52, 272, 279, 280, 282-284 etj) të LPP I referohen nenet për policinë e jurisposidencës, kun ë nenin 284 paragrafi një thuhet se: Prokurori publike vet ose nëpërmjet policies së jurisposidencës, respektivisht personave tjerë të punësuar në qendrat hetuese tën prokurorisë publike, mbledhni njoftime të nevojshme për vendimarrje për kallximin penal, kurse sipas nevojës atë e kryejn edhe përmes policies ose organeve tjera kompetenete për zbulim.⁹⁵

Detyrat e policies së jurisposidencës janë që sipas detyrës zyrtare ose me urdhër të prokurorit publik të ndërmerr masa dhe aktivitete me qëllim të zbulimit dhe hetimit kriminalistik të veprave penale, kapjes dhe denocimit të kryersëve të tyre, sigurimit të provave dhe masave si dhe të aktiviteteve tjera të cilat mund të shfrytëzohen për realizimin e papenguar të procedurës penale. Eprorët e policies së jurisposidencës janë udhëheqësit e njesive organizative në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në Drejtorinë e Policisë Finaciare dhe në Drejtorinë Doganore, të cilët janë në lidhje të drejtpërdrejt me prokurorin publik.⁹⁶

4. Roli i entit social në parandalimin e delikuencës së të miturve

Për rastet e delikuencës së të miturve dhe sjelljet e tjera asociale QPS-të në Kosovë, zakonisht njoftohen nga prokuroria dhe policia qoftë me raport të shkruar apo me telefon. Të rralla janë rastet kur prindërit ia referojnë qendrës sjelljet delikuede të fëmijëve të vet. Përgjashtim bëjnë shkollat, kur nxënësit problematikë dhe me sjellje devijuese përmes një regjistri ia përcjellin QPS-së për trajtim risocializues të tyre.

⁹⁴ I. Zejneli, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, faqe 94

⁹⁵ Ligji Për Procedurë Penale I Republikës së Maqedonisë së Veriut, Neni 272-284

⁹⁶ I. Zejneli, E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, faqe 222

Puna e parë që bëjnë nëpunësit e shërbimeve sociale lidhur me trajtimin e delinkuentëve të mitur është evidentimi i rastit dhe caktimi i një nëpunësi që do të drejtojë trajtimin e tij. Hapi i dytë është kontaktimi me familjen dhe me vetë të miturin, me shkollën që e ndjek, si edhe me rrethin shoqëror, në mënyrë që të njihet më mirë personaliteti i të miturit. I mituri dhe familja e tij këshillohen nga nëpunësi për sjelljet e të miturve, shpjegohet rreziku dhe pasojat për të ardhmen dhe vihet në dukje nevoja e përkujdesjes së shtuar të prindërve.⁹⁷

Në varësi nga rasti dhe nevoja QPS-ja, sipas detyrës zyrtare, mund ta drejtojë të miturin për trajtim edhe te ndonjë subjekt tjetër shoqëror, p.sh. në institucionin shëndetësor etj. Nëse rastin e ka paraqitur gjykata, ajo krahas njoftimit, kërkon edhe raportin hetues social, të dhënat për të miturin dhe mendimin e organit të kujdestarisë për zhvillimin e procedurës së mëtejshme. Nëpunësi i shërbimeve sociale, i ngarkuar si udhëheqës i rastit, ka për detyrë që, bashkë me njëpunëtor tjetër ndihmës të përgatisë raportin social hetues për të miturin brenda afatit të caktuar dhe t'ia dërgojë gjykatës kompetente. Sipas nevojës, e me ftesë të gjykatës, nëpunësi merr pjesë edhe në seancat gjyqësore deri në përfundimin e procedurës. Në rastet kur për të miturin caktohen masat edukuese, nëpunësi i QPS-së nuk përfundon punën me të miturin. Nëse jepet masa edukuese e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e organit të kujdestarisë, nëpunësi ngarkohet edhe me shumë me punë me të miturin. Nëse i mituri dërgohet në qendër edukuese- korrektuese nëpunësi i QPS-së e viziton dhe kontakton me personelin e entit me qëllim që ta përcjellë procesin e risocializimit të të miturve dhe kërkon një raport me shkrim.⁹⁸

Pas kryerjes së masës së dhënë nga ana e gjyqit, organi i kujdestarisë pranë QPS-së është i detyruar që ta ndjekë më tej se si po ecën procesi i risocializimit në shkollë, në punë dhe kudo gjetiu me qëllim që ai të rehabilitohet plotësisht dhe t'i ndryshojë botëkuptimet e qëndrimet e mëparshme. Pastaj vështirësia vazhdon në procesin e risocializimit të të miturve delinkuentë. Më e rëndësishme është faza pas sanksioneve, në të cilën shoqëria e gjerë zakonisht ngurron ta pranojë të miturin si anëtar të barabartë, kështu që, për shkak të këtij stigmatizimi, i mituri i risocializuar shumë lehtë mund të bëhet recidivist.

5. Roli i mas-mediave në parandalimin e delikuencës së të miturve

Për luftimin e kriminaliteitit dhe masave parandaluese të tij rol jashtëzakonisht të madh si pozitiv dhe negativ kanë mas-mediat, për luftimin e kriminalitetit dhe të zhvillimit shoqërorë antikriminal, rol të posaçshëm ka informimi i drejtë i qytetarëve në lidhje me dukurit dhe

⁹⁷ Ligji Nr. 02/L-17, Për Shërbime Sociale dhe Familjare, 2007

⁹⁸ (Po aty)

shjelljet delikuate dhe kriminale.

Mjetet e komunikimit masiv në botën bashkohore, janë bërë mjete të fuqishme të ndikimit dhe orejentimit të opinionit brenda një vendi apo opinionit ndërkombëtarë.

Si mjete të komunikimit masovik, në literaturën kriminologjike konsiderohet: shtypi i ilustruar, shtypi zbavitës, literatura, televizioni, radio, filmi, portalet etj.

Prezantimi selektiv, përleshjeve, plaçkitjeve, dhunimeve të një kategori të njerzve, e sidomos të rinjëve nxisin motive të ulta, emocionale dhe epsh të shfrenuar, psikoze të frikës dhe pasigurisë.⁹⁹

Shtypi i përditshëm, revistat e ndryshme ilustrative, literatura, filmat me përmbajtje dhe porosi të dyshimta, fatkeqësisht në shumë vende shpeshherë edhe dominojnë dhe janë shumë prezentë. Në përmbajtjen e gazetave, filmave në shumicën e rasteve është prezent dhe dominon dhuna, sjelljet delikuate, pornografia, prostitucioni dhe përmbajtje të tjera të dyshimta.

Mas mediat duhet të jenë të vedishëm për fuqinë e tyre të cilat janë prezent në të gjithë porët e shoqërisë, dhe fuqinë e tyre duhet ta përdorin për parandalimin e kriminalitetit dhe jo për shtimin e tij.¹⁰⁰

Mas mediat në shumicën e rasteve shfaqin në mediat e tyre përmbajtje që nuk është e përshtatshme për të miturit siç janë: krimet e ndryshme, lojrat e fatit online, pornografit ndryshme dhe sjellje të tjera delikuate, ku tek të miturit ka efekt jashtëzakonisht negativ dhe ndikon në shtimin e kriminalitetit.

Mas mediat këtë e bëjnë vetëm për përfitime mirpo kjo është vetëm njëra pjesë e medaljes, pjesa tjetër është se media e sidomos media televizive ndikon tek të miturit për parandalimi me reklamime të ndryshme kundër krimeve me prezantimin e dokumentarëve të ndryshëm etj.

Mund të them se shqetësimi i përgjithshëm ka qenë dhe akoma mbetet sidomos roli i medias elektronike, të cilat kanë dalë në disa raste më në pah si faktorë të ndikimit negativ në procesin e gjatë e të vështirë të edukimit të të rinjëve dhe adoleshentëve mbi bazën e etikës dhe moralit të shëndosh tradicional, duke i prerë rrugën ndikime negative në ç'dukimin e tyre me moral të papranueshëm të transmetuara nga emisionet e huaja televizive, të cilat japin gati çdo ditë filma pornografikë, terror, horror, dhunë, vrasje, vjedhje spektakolare, krime të ndryshme, të cilat edhe pse një pjesë janë fantastikë, imagjinarë dhe jo reale, ndikojnë së tepërmi tek të rinjtë tanë, akoma më tepër, kur për to nuk ka spjegime realiste, ose aq më keq

⁹⁹ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë 2018, faqe 134

¹⁰⁰ (Po aty)

akoma kur nuk ndalohen, ose kur nuk çensurohen.¹⁰¹

Në pak sekuenca televizive një i ri shikon një femër gjysëm e çveshur që e josh duke i thënë që të vinte në takim “për të mësuar eksperiencën të reja në jetën seksuale”...pastaj shikon heronjë nëpër kazino me trukimet e tyre, filma West dhe reklama pa fund.

Disa shtete evropiane kanë ndaluar transmetimet e televizorëve që konsiderojnë jashtë standarteve të tyre etiko-moral, duke vënë dhe njoftime për mosndjekjen e tyre, sidomos nga adoleshentët dhe të rinjtë.

Ndekja e filmave me përmajtje provokuese për të miturit ndikon dëmshëm. Porosti që dërgohen përmes këtyre videoklipeve, video lojrave tek të miturit lëjnë gjurmë të rënda e në disa raste edhe pasoja shumë të mëdha dhe të paparashikuara.¹⁰²

Interneti sot në botë paraqet mjetin më të rëndësishëm të njeriut, në punë dhe zhvillimin më efikas të tij. Sot interneti nuk përdoret vetëm nga të rriturit por edhe nga të miturit dhe fëmijët, ai ofron shumë mundësi për punë, për njohje të civilizuar me të gjitha anë pozitive që kanë, mirpo edhe sjelljet asociale që tek ne janë të ndaluara.¹⁰³

Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka paraparë veprën penale që është në nenin 264-Hyrje në sistemin kompjuterik, ku thuhet: kushdo që në mënyrë të paautorizuar dhe me qëllim për vete ose për personin tjetër ti sjellë doli pasurore të paligjshme, apo ti shkaktoj dëm personin tjetër ndryshon, publikon, shlyen, asgjëson apo shkatërron të dhëna kompjuterike, programe kompjuterike apo në çfardo mënyrë tjetër hyn në sistem kompjuterik dënohet me gjobë apo mu burgim deri në tre vite.¹⁰⁴

Format më të shpeshta të krimit me kompjuter janë: vjedhjet e informatave, vjedhjet e programeve, futja e virusave ndryshe të njohura edhe si bomba logjike, në program apo në sistem kompjuterik. Forma tjera të kriminalitetit kompjuterik përmenden edhe mashtrimet kompjuterike, marrja e paautorizuar e shënimeve dhe informatave, pasurimi i paautorizuar, shkatërimi i informatave dhe programeve, pengimi i punës së kompjuterit dhe programeve të caktuara.

Të dhënat tregojnë se interneti tek të mitur shkaktonë jashtëzkonisht dëme dhe shtytje për sjellje asociale dhe kriminale.

Sipas të dhënave shohim se në vitin 2018, të dhënat e paraqitura tregojnë se mosha mesatare e personave të cilët për herë të parë kanë shikuar filma pornografik në internet është mosha pre

¹⁰¹ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë 2018, faqe 138

¹⁰² R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2016, faqe 265

¹⁰³ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë 2018, faqe 139

¹⁰⁴ Kodi Nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2019, Neni 264

12 deri në 17 vjeç.¹⁰⁵

Industria pornografike në internet është se 20-30 % të qarkullimit në sajte e realizon nga të miturit.

Si masë preventive që fëmijët të mos jenë të prekur nga pornografia dhe sjellet e tjera asociale që shfaqen në internet prindërit duhen që kompjuterin ta vendosin në vend qendrorë, në dhomë apo në klasë, me qëllim që prindërit të mund të kontrollojnë kohë pas kohe se çka janë duke shikuar fëmijët në kompjuter. Kjo është shumë e rëndësishme që të vërehet nëse fëmijë rastësisht hasin apo vizitojnë programe me përmbajtje jo të duhur për ta dhe për moshën e tyre të cilën e kanë.¹⁰⁶

Prindërit në mënyrë permanente duhet ti kenë fëmijët e tyre nën kontrollë gjatë pordorimit të kompjuterit dhe pasijeve të tjera, prindërit gjithmonë duhet ti japin fëmijëve të tyre këshilla për pordorimin, ruajtës së të dhënave personale, përdorimin e fotografive, evitimin e situatave jo të këndshme etj.

Në vijim do ti paraqesim disa rekomandimi si të mos bijemi viktimë e internetit, si dhe parandalimin e sjellejeve delikuenta nga të miturit, rekomandimit janë nga organizatat botrore që mirren me krimet kibernetike që më së shumti i prek të miturit.

- Asnjëherë mos shtoni apo pranoni si miq në rrjete sociale të cilët kanë të bëjnë me median.
- Asnjëherë mos jepni të dhëna personale si adresën ose numrin e telefonit.
- Respektoni udhëzimet për kriterin e moshës që vendosin rrjetet sociale.
- Mos i u përgjigj asnjë mesazhi kërcënues apo fytes.
- Ruaj çdo detaj të mesazheve ose emaileve që merr.
- Bloko dhe raporto adresat nga vijnë mesazhet fyese dhe kërcënuese.
- Lajmëroni dhe telefononi për të raportuar rastet e abuzimit që hasin në mediat në numrat të cilët janë adekuat për të lajmruar.¹⁰⁷

Literatura sikurse shtypi dhe interneti është faktorë i rëndësishëm dhe ka një ndikim pozitiv në ngritjen dhe edukimin e gjeneratave të reja, literatura në shumicën e rasteve ndikon jashtëzakonisht mirë dhe pozitivisht tek të miturit.

Mirpo për fat të keq kohëve të fundit literatura ka filluar të ndikoj negativisht te një grup i caktuar të miturish, literatura e cila ka përmbajtje zbavitëse dhe avantureske e sidomos literaqtura që ka të bëjë me romanet kriminalistike, romanet pornografike, që nuk kanë kurrfarë vlere dhe sjapin asnjë llojë porositë tek lexuesi.

¹⁰⁵ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë 2018, faqe 138

¹⁰⁶ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë 2018, faqe 143

¹⁰⁷ Isigurt.al-Platforma Kobëtare për Sigurinë e Fëmijëve në Internet

Këto lloje të literaturës sipas shumë studimeve tek të miturit shfaqin ndjenja dhe emocione ireale, motive të ulta, krijojnë shprehje dhe pasione të cilat shpeshherë dërgojnë dhe janë shkaktarë të sjelljeve kriminale.¹⁰⁸

Ndikim kryesore dhe të fuqishëm kjo llojë e literaturës ka tek të miturit që nuk janë stabil në pikpamje shpirtërore dhe emocionale, dhe të mitur të tjerë që më parë kanë kryer sjellje asociale dhe kriminale si dhe një grup i posaçë i të miturve që shumë lehtë i nënshtrohet ndikimeve negative që i marrin nga literaturat e ndryshme dhe i paraqesin dhe i manifestojnë ato në praktikë dhe në jetën e përditshme.

Mirpo si masë kryesore se si duhet të veprohet që të miturit mos të mund të paisen me këtë lloj literature, duhet të kenë kufizimi ku në qoftëse nuk e kanë moshën adekuate nuk duhet të paisen dhe nuk duhet të bëjnë blerjen e ktyre romaneve kriminalistike, revistave pornografike dhe literaturës tjetër, pas ndikim negativ tek ta.¹⁰⁹

Smund të themi se literatura dhe mas media në përgjithsi e kanë fajin e paraqitjes së kriminalitetit tek të miturit dhe ata janë ndikuesit dhe faktorët kryesorë në paraqitjen e sjelljeve asociale.

Këto faktorë ndikojnë kryesisht tek ata të mitur që i kanë edhe disa faktorë tjerë paradisponues siç janë: jostabilitetit emocional, varfëria apo kushtet e papërshtatshme jetësore, raportet dhe konfliktet e çregulluara familjare, dhe faktorë tjerë paradisponues ku i kontribuojnë kësaj dukurie tek të miturit.¹¹⁰

6. Të dhënat hulumtuese mbi punimin-Aktgjykimet nga Gjykata themelore Gjilan – Departamenti për të Mitur si dhe Aktgjykime nga Gjykata e Apelit-Kolegji për të Mitur

Në vijim do të paraqesim raste konkrete të veprave penale të kryer nga të miturit në rrethin e Gjilanit, si dhe të shohim aktgjykimet të marrura nga Gjykata themelore Gjilan departamenti për të mitur nën Gjykatën Themelore Gjilan, si dhe aktgjykimin e Gjykatës Penale departamenti për të mitur, do të elaborojmë aktgjykimet si dhe do të analizojmë çështjet procedurale si dhe llojet e sanksioneve dhe masat e tjera të shqiptuara në aktgjykim.

Rastin e parë për elaborim e kemi marrur nga Gjykata Themelore Gjilan Departamenti për të Mitur me numrin e lëndës:2019: 184815 i datës 22.11.2019 me numër dokumenti: 00669381, PKR.nr.164/2019.

¹⁰⁸ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 145

¹⁰⁹ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, faqe 266

¹¹⁰ I. Zejneli, Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018, faqe 145

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, departamenti për të mitur, përmes gjyqtarit për të mitur, **Sahit Boroci**, me zyrtaren ligjore **Hikmete Veliu - Pajaziti** si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit, **L.B.** nga fshati L... , komuna e Kamenicës të cilin sipas autorizimit e mbron **av. S.S.** nga Kamenica për shkak të veprës penale, ngacmimi seksual nga neni 183 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPKK-ës), sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan (në tekstin e mëtutjeshëm PTHDKR) PP.I.nr .147 /2019 të datës 14.10.2019 të cilën e përfaqëson prokurorja **Rabije Jakupi** ,pas mbajtjes së seancës për negociimin e marrëveshjen për pranimin e fajësisë të datës 19.11.2019, në të njëjtën ditë mori ndërsa me datën 21.11.2019 shpalli, kurse me datën 22.11.2019 përpiloi këtë:

Aktgjykim

I akuzuari, **L.B.** L.B. nga babai Z. dhe nëna M., e lindur H., i lindur me datën...në Gjilan, me vendbanim në fshatin L..., Komuna e Kamenicës, ka të kryer shkollën e mesme drejtimi “Auto Mekanik”, i pa martuar, i gjendjes se varfër ekonomike, shqiptar i Republikës së Kosovës.

Është Fajtor

Sepse me datën 12.08.2019 rreth orës 09.15 min., në lagjen “Malësia” në Kamenicë , e ka ngacmuar seksualisht, tani të dëmtuarën-të miturën O.J. e moshës 14 vjeqare e lindur më datën 24.11.2004, në atë mënyrë që pasi janë njoftuar nëpërmes rrjetit social Instagram para dy viteve i kanë vazhduar bisedat, ndërsa me datën e lartë përmendur janë takuar te lagjja “Malësia” dhe kanë ecur përpjetë dhe në një moment kanë hyrë në mal-pisha, ku kanë qëndruar nga ora 10.00 e mëngjesit e deri në ora 13.00, ku gjatë asaj kohe i pandehuri e ka shfrytëzuar pozitën e saj të ndjeshme për shkak të moshës dhe me veprim të drejtëpërdrejt

duke e prekur me duar, duke e përqaftuar, e puthur në faqe edhe pse e ka ditur se e dëmtuara është e moshës së mitur.

-me këtë ka kryer veprën penale ngacmimi seksual nga neni 183 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve të lart cekura si dhe nenet 4, 40, 42, 44, 69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës si dhe nenit dhe 233 dhe 365 të KPP-ës, të pandehurin Lirigzon Bunjaku e,

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **60** (gjashtë dhjetë) ditësh, të cilin dënim i akuzuari detyrohet ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita vijuese kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

E pas shpalljes së aktgjykimit me pëlqimin e deklaruar shprehimisht të pandehurit , ky dënim i shqiptuar me burgim në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, i

ZËVENDËSOHET ME DENIM GJOBË

Në shumën prej 300 (treqind) €, të cilin dënim i pandehuri detyrohet që ta paguaj në afat prej **90 (nëntëdhjetë)** ditësh nga dita vijuese kur ky aktgjykim i plotfuqishëm . Mirëpo në qoftë se i akuzuari nuk e paguan ose nuk dëshiron që ta paguaj dënimin me gjobë, në atë raste i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60(gjashtëdhjetë) ditëve.

I. DETYROHET i akuzuari që kësaj gjykate t’ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumë prej 25 €.

II. Shumën prej 50 € në emër të kompensimin e viktimave te krimit. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita vijuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIMI

PTHDKR. në Gjilan me datën 14.10.2019 ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr 147/2019 kundër të

akuzuarit L.B. nga fshati L... , komuna e Kamenicës, për shkak të veprës penale, ngacmimi seksual nga neni 183 paragrafi paragrafi 1 të KPRK-ës.

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti për të mitur e ka paraqitur në gjykatë marrëveshjen për pranimin e fajësisë të nënshkruar nga prokurorja e çështjes Rabije Jakupi, i pandehuri L.B. dhe mbrojtësi i tij av. S.S. nga Kamenica me autorizim si ne shkresat e lëndës.

Gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë prezantuar Prokurorja e prokurorisë Themelore në Gjilan, Rabije Jakupi si dhe i akuzuari me mbrojtësin e tij, ndërsa me rastin e shpalljes së aktgjykimit nuk ka prezantuar askush nga palët.

Në seancën dëgjimore mbi negociimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të mbajtur me datën 20.11.2019 prokurorja e PTHDM. në Gjilan, **Rabije Jakupi** në fjalën e saj deklaroi: Do të doja që në këtë seancë ta paraqes marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP.I.nr.147/2019 të datës 14.10.2019 , e të cilën e kemi dorëzuar në gjykatë me datën 15.10.2019 , që e kemi arritur me tani të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij.

Mbrojtësi i viktimave **G.L.** deklaroi: meqenëse viktimat e mitur nuk prezanton në këtë shqyrtim gjyqësor, konsideroj se duke pasur parasysh veprën penale e cila ju është vënë në barrë të pandehurit, ne e pranojmë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ndërsa kërkojmë kompensim dëmi në emër të viktimës, për shkak të moshës së saj të ndjeshme dhe pozitës së saj gjithashtu të ndjeshme nuk ka mundur ta kuptoj veprën e cila është e ndalura me ligj.

I akuzuari **L.B.** deklaroi: mbetem pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të datës 14.10.2019 dhe nuk kam tjetër se çka të shtoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit **Av.S.S.** deklaroi: e mbështes deklaratën e të mbrojturit mbi marrëveshjen e arritur për pranimin e fajësisë. I mbrojturi im është i vetëdijshëm lidhur me atë që ka pranuar, e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, e të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës janë të pranueshme dhe për këtë i mbrojturi im është në dijeni, prandaj i propozoj gjykatës që ta pranoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Pas mbajtjes së seancës dëgjimore me dëgjimin e palëve e në mbështetje të nenit 233 paragrafi 21 e lidhur me nenin 18 të KPPK-ës gjyqtari për të mitur konstatoi se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj, andaj vendosi që të pranohet marrëveshja për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të PTHDM. në Gjilan në njërën anë dhe të pandehurit L.B. me mbrojtësin e tij në anën tjetër për shkak të kryerjes së veprës penale, ngacmimi seksual nga neni 183 paragrafi 1 të KPRK.

Mbrojtësi i të pandehurit **L.B., av.S.S.,** në fjalën e tij deklaroi: pas konsultimeve paraprake me të pandehurin, me datën 09.08.2019 e kemi arritur një marrëveshje për pranimin e fajësisë

me prokurorinë Themelore në Gjilan, andaj në tërësi mbetemi pran asaj marrëveshje.

I akuzuari **L.B.** në fjalën e tij deklaroi: në tërësi e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim, i kërkoj falje të dëmtuarës dhe premtoj që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale.

Gjyqtari për të mitur, në bazë të nenit 233 paragrafi 21 të KPP. vendosi që data e 09.08.2019 të jetë datë kur palët i japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin e që një gjë e tillë është bërë menjëherë.

PSH. **Rabije Jakupi** ka deklaruar: mbetem në tretësi pranë marrëveshjes lidhur me pranimin e fajësisë dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënimin sikurse është evidentuar në këtë marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit **Av.S.S.** deklaroi: faktet e prezantuara nga prokuroria qëndrojnë, andaj e mbështes marrëveshjen lidhur me pranimin e fajësisë edhe sa i përket dënimit mbi të mbrojturin tim dhe i propozoj gjykatës duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të pandehurit gjatë shqiptimit të dënimit me gjobë, mundësisht shuma e gjobës të jetë sa më e ulët.

I akuzuari **L.B.** deklaroi: mbetem në tërësi pran marrëveshjes lidhur me pranimin e fajësisë, i kërkoj falje të dëmtuarës dhe premtoj që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera të kundërligjshme.

Rrjedhimisht, gjyqtari për të mitur ka qenë i bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal dhe se nënshkrimi i marrëveshjes nga ana e të pandehurit është bërë vullnetarisht se pranimi i fajit është mbështetur në faktet e çështjes që i përmban aktakuza me provat e propozuara nga prokuroria.

Pra një gjendje të këtillë faktike të pa kontestueshme gjyqtari për të mitur gjeti se në veprimet e të akuzuarit L.B. ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si më lartë, andaj të njëjtin e shpalli fajtor dhe penalisht përgjegjës.

Sipas bindjes së gjyqtarit për të mitur, dënimi sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi është i drejtë në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se mund të pritet që edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i paraparë në nenin 38 të KPRK. si dhe ky dënim do të ndikoj në të akuzuarin dhe personat potencial ku jetojnë dhe veprojnë që në të ardhmen të përmbahen nga kryerja e veprave tjera penale. Prandaj e aprovoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.

Vendimi mbi detyrimin që i pandehuri të paguaj shumen prej 50€ në emër të kompensimit e

viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjyqtari për të mitur vendosi për kërkesën pasurore juridike duke u bazuar në nenin 463 para.1 dhe 2 të KPK-ës.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

-Departamenti për të mitur- PKR.nr.164/2019

Me datën 22.11.2019.

Zyrtare ligjore

Hikmete Veliu –Pajaziti

Gjyqtari për të mitur

Sahit Boroci

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, departamenti për të mitur në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi se të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

Nga ky aktgjykim mund të vijemi në përfundim se Pra duke i a bërë analizën këtij aktgjykimi shohim se veprën penale të cilën e ka kryer i pandehuri ka të bëjë me sulm seksual ndaj personit të mitur që në këtë rast është i moshës 14 vjeçare, gjithashtu gjykata pasi ka parë rastin se është çështje penale për të mitur, gjykata aktygjimimi e saj e ka marrë përmes Gjyksatit për të mitur që mirret vetëm me çështje penale për të mitur, si dhe në departamentin për të mitur nën Gjykatën Themelore Gjilan.

Vërejmë se Gjykatësi pas ndëgjimit të pandehurit dhe avokatit të tij si dhe pas dëgjimit të prokurorit të rastit ka marrë shqiptimin e masës, nga ky aktygjikim vërejmë edhe instituti e ri në procedurë penale marveshja mbi pranimin e fajit, ku kryersi së bashku me prokurorin janë pajtur me shqiptimin e dënimit dhe masës së tij dhe ne seancë përfundimtare e kanë paraqitur marveshjen e pranimi fajit të nënshkruar nga prokurori dhe i pandehuri, gjithashtu Gjykatësi ka marrë për bazë pranimin e fajit dhe pendimit e tij si dhe premtimin e kryersit se në të ardhmën nuk do të kryej vepra penale të këtilla si dhe deklaratatën e mbrojtësit se gjendja ekonomike e kryersit është e rënduar dhe është kryersi primarë i veprës penale.

Dhe pas dëgjimit të palëve në procedurë penale dhe shoshitjes së provave, gjykatësi ka marrë vendim duke u bazuar në Kodin penal, në Ligjin për procedurë penales si dhe në Kodin mbi

Drejtësin e Fëmijëve.

Gjykata shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtë dhjetë) ditësh, të cilin dënim i akuzuari detyrohet ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita vijuese kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm. Mirpo Gjykata për rrethana të ndryshme shqiptoj edhe masaën e dënimit alternativ ku bashkarisht shqiptoj edhe ZËVENDËSOHET ME DENIM GJOBË.

Në shumën prej 300 (treqind) €, të cilin dënim i pandehuri detyrohet që ta paguaj në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita vijuese kur ky aktgjykim i plotfuqishëm . Mirëpo në qoftë se i akuzuari nuk e paguan ose nuk dëshiron që ta paguaj dënimin me gjobë, në atë raste i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60(gjashtëdhjetë) ditëve.

Gjitashtu detyrohet i akuzuari që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumë prej 25 €, si dhe shumën prej 50 € në emër të kompensimin e viktimave të krimit. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita vijuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kurse rasti I dytë ka të bëjë me aktgjykimin në Gjykatën Penale Departamenti për të mitur, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të miturit J.E., I përfaqësuar nga avokati .I.D., të ushtuar ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti për të Mitur, PM.nr.105/2019, të dt.04.11.2019.

Gjykata e Apelit, Kolegji për të mitur i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Gani Zabeli, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Jeton

Leci, nxejri aktgjykimin me numër PAM.nr.92/2019.

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji për të mitur i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Gani Zabeli, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Jeton Leci, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të miturit J.E., nga fshati ..., Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të miturit J.E., av.I.D., të ushtuar ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti për të Mitur, PM.nr.105/2019, të dt.04.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.30.12.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit së të miturit J.E., av.I.D., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan - Departamenti për të Mitur, PM.nr.105/2019, të dt.04.11.2019, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan - Departamenti për të Mitur, PM.nr.105/2019, të dt.04.11.2019, është shpallur përgjegjës i mituri J.E., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar masa edukative institucionale, dërgimi në institucionin edukativo korrektues, në kohëzgjatje prej 1(një)viti, në afat të verifikimit prej 2(dy)viteve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, po qesë i mituri nuk kryen ndonjë vepër të re penale. Në masën e shqiptuar i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.04.09.2019, gjerë me dt.29.10.2019.

Kjo masë do të revokohet po qesë i mituri kryen ndonjë vepër të re penale. Shpenzimet e procedurës penale bijën në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në kuptim të nenit 267 par.5 të KPK, të miturit i konfiskohet substanca narkotike, e llojit marihuan, në peshë prej 31.9gr dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e njëjta duhet të asgjësohet nga organet kompetente.

Gjithashtu të miturit i konfiskohet shuma e parave në vlerë prej 100Euro, e cila pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, duhet të dorëzohet në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Të miturit i është ndërprerë masa e paraburgimit me dt.29.10.2019, dhe është liruar po të njëjtën ditë.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të miturit J.E., av.I.D., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe ka propozuar, që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të miturit ti zvogëlohet afati verifikues i masës së kushtëzuar.

Prokuroria e Apelit me shkresën PPAM/I.nr.144/2019, të datës 10.12.2019, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, nga ana e mbrojtësit së të miturit J.E., av.I.D., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji për të mitur, ka caktuar seancën e kolegjit për dt.30.12.2019, dhe i ka njoftuar të gjitha palët e propozuara në mënyrë të rregullt. Nga shkresat e lëndës rezulton se në seancë të kolegjit kanë prezantuar, përfaqësuesja ligjore e të miturit, nëna V.E., përfaqësuesi i Shërbimit Sprovues të Kosovës - Zyra Rajonale në Gjilan, i mituri J.E., ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, mbrojtësi i të miturit, av.I.D., përkundër asaj që janë njoftuar në mënyrë të rregullt, e cila rezulton nga shkresat e lëndës. Gjykata e Apelit, kolegji për të mitur, në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, aktvendimin e ankimuar, propozimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit së të miturit J.E., av.I.D., nuk është e bazuar

Meqenëse aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktvendimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtësit së të miturit, av.I.D., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke pretenduar se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, nuk janë vlerësuar në masë të duhur rrethanat lehtësuese, duke pasur parasysh se i mituri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është penduar thellësisht dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin, se është nxënë i rregullt i shkollës së mesme, andaj shqiptimi i masës sikurse në dispozitiv të aktgjyimit, do të vështirëson rrjedhjen e vijimit të shkollimit të mëtutjeshëm dhe jemi të bindur se me masën edukative mbikëqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i masës së shqiptuar, sikurse është e paraparë në dispozitat përkatëse ligjore dhe se me masën e shqiptuar nuk do të ndikohet me përmirësimin dhe riedukimin e të miturit. Duke i ndjekur të gjitha këto të theksuara, jemi të mendimit se kohëzgjatja e verifikimit të masës së shqiptuar, është e gjatë dhe propozon që e njëjta të jetë në kohëzgjatje më të shkurtë.

Kolegji për të mitur i kësaj gjykate, ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së

ushtruar nga ana e mbrojtësit së të miturit, dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, dhe se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj, është ardhur në përfundim se, gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin ka aplikuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore kur të miturit i ka shqiptuar masën sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, sepse ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese sikurse janë, se i mituri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është penduar thellësisht për kryerjen e të njëjtës dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin, se është i sjellshëm në familje, e cila është vërtetuar edhe nga ana e përfaqësueses ligjore-nënës së tij, se është përmirësuar dukshëm, e cila rezulton edhe nga raporti i Shërbimit Sprovues të Kosovës, Zyra Rajonale në Gjiilan, gjithashtu ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, e sidomos mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe rrethanat e kryerjes së të njëjtës, se i njëjti nuk është përmirësuar përkundër asaj që ka pasur të shqiptuar masën mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, andaj, kolegji i kësaj gjykatë është i bindur se me masën e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i masës së shqiptuar, në kuptim të nenit 22 të KDM, lidhur me nenin 38 të KPK, dhe nenin 3 të Konventës Ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve, që të parandaloj kryerësin e mitur nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga kjo që u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 KPPK, lidhur me nenin 5 të KDM, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS

PAM.nr.92/2019, të datës 30.12.2019

B. professional

Jeton Leci

Anëtarët e kolegjit

Hashim Çollaku

Gani Zabeli

Kryetari i kolegjit

Ferit Osmani

Pra siç e shofim nga ky aktgjykim kemi ankesë nga mbrojtësi I të pandehurit, për vendimin e Gjykatës Themelore Gjilan Departamenti për të mitur I marur nga Gjykatësi për të mitur, duke shqiptuar sanksionin penal është shqiptuar masa edukative institucionale, dërgimi në institucionin edukativo korrektues, në kohëzgjatje prej 1(një) viti, në afat të verifikimit prej 2-dy dviteve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, po qesë i mituri nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Ku I pandehuri dhe avokati I tij kanë bërë ankesë në Gjykatën e apelit, Kolegji për të mitur I përbërë nga Gjykatësit për të mitur si dhe bashkpuntorin professional.

Ku Gjykata e apelit jep Aktgjykim: Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit së të miturit J.E, me avokatin e tij I.D, kurse aktgjykimi I Gjykatës Themelore Gjilan- Departamenti për të Mitur, PM.nr.105/2019, të dt.04.11.2019, Vërtetohet.

Gjykata e apelit e ka ardhur në përfundim se gjatë shqiptimit të aktgjykimit nga Gjykata themelore nuk ka shkelje esenciale të dispozitave si dhe sanksioni penal është shqiptuar në përpushmëri me legjislacionet penale vendase.

Gjithashtu Gjykata themelore e ka marrë për bazë rrethan lehtësuese sikurse janë, se I mituri e ka pranuar fajsinë për veprën penale e cila vihet në barrë, gjithashtu është penduar thellësisht për kryerjen e të njetës si dhe ka premtuar që në të ardhmën nuk do të bie në kundërshtim me ligjin.

Në momentin kur kryersi ka kryer veprën penale janë gjendur sasi e konsideruar e narkotikëve ku menjëher I kanë marrë policia dhe kanë hapur procedure për asgjësim, gjithashtu të pandehurit I janë gjetur shumë monedha në vlerë 100 euro të cilat do të depozitohen në buxhetin shtetërorë.

Gjykata e apelit pasi e ka zhvilluar seancën, ka parë se mbrojtësi ka bërë ankesë lidhur me shqiptimin e sanksioneve se nuk është e përshtatshme për mbrojtësin e tij pasi është ende në shkollë të mesme etj.

Mirpo kjo automatikisht është hedhur si e pa bazuar për arsye se aktvendimi I Gjykatës Themelore së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktvendimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

6.1. Të dhënat statistikore nga Agjensioni statistikor i Kosovës, si dhe Statistikat nga Gjykata Themelore Gjilan- Departamenti për të Mitur, si dhe Statistikat nga Gjykata themelore Gjilan.

Nga të dhënat e Agjencis së Statistikave të Kosovës kemi paraqitur Numrn e personave të akuzuar dhe mënyra e zgjedhjes së propozim akuzës për të mitur sipas Gjykatave Themelore, në formë tabelare. Në Gjykatën Thmelore Gjilan kemi 218 të akuzuar, 41 aktgjykime dënuese, 3 masë disiplinore, 95 masë e mbikëqyrjes, 11 masa e enteve dhe 68 mënyra të tjera. Në Gjykatën Themelore Prishtinë numri I të akuzuarve është 389, ku 124 janë aktvendimie dënuese, 6 masa disiplinore, 104 masa të mbikqyrjes, 10 masa të enteve, 6 punë në dobi të përgjithshme, 7 aktvendim refuzues dhe 132 mënyra tjera. Edhe në Gjykatën Themelore Mitrovic kemi 53 të mitur të akuzuar, 17 persona me aktvendim dënues, 4 persona masë disiplinore, 9 masë e mbiksqyrjes, 1 masë e enteve , 2 persona të dënuar punë në dobi të përgjithshme dhe 20 në mënyra tjera.

Gjithsej kemi 1179 të akuzuar, 118 aktgjykim dënues, 42 masë disiplinore, 396 masë e mbikqyrjes, 48 masa e enteve, 39 të dënuar me punë në dobi të përgjithshëm, 12 aktvendim refuzues dhe 454 mënyra të tjera.


Tabela: 7

Nr.rendor	Emri i Gjykatave	Numri i të akuzuarve	Mënyra e zgjidhjes së aktakuzës								
			Aktgjykim dënues	Aktgjykim lirues	Refuzim i aktakuzës	Aktvendim masë disiplinore	Aktvendim masë mbikëqyrëse	Aktvendim masë e enteve	Aktvendim urdhër për punë në dobi të përgjithshme	Aktvendim pezullues	Mënyrë tjetër
1	Gjykata Themelore Gjilan	218	41	-	-	3	95	11	-	-	68
2	Gjykata Themelore Prizren	170	4	-	-	25	32	15	3	-	91
3	Gjykata Themelore Pejë	36	1	-	-	-	27	2	2	2	2
4	Gjykata Themelore Gjakovë	49	1	-	-	1	27	6	1	-	13
5	Gjykata Themelore Prishtinë	389	124	-	-	6	104	10	6	7	132
6	Gjykata Themelore Ferizaj	264	-	-	-	3	102	3	25	3	128
7	Gjykata Themelore Mitrovicë	53	17	-	-	4	9	1	2	-	20
	Gj i t h s e j:	1.179	188	-	-	42	396	48	39	12	454
	%	100	15,9	-	-	3,6	33,6	4,1	3,3	1,0	38,5

Janë të dhënat e njeta sikurse tabela më sipër, vetëm e paraqitur në mënyrën e grafikonave dhe në përqindje ku 33.6 % është shqiptuar aktvendimi masës së mbikëqyrjes, 15.9 % aktgjykim dënues, 3.6 % masë disiplinore, 4.1 % masa e e enteve, 3.3 % aktvendimi urdhër me punë në dobi të përgjithsme 1.0 % aktvendime pezulluese, 38.5 % mënyrë tjetër.

Nurmi i paraqitur në përqindje është numri total i të akuzuarve mbrenda Republikës së Kosovës dhe mënyra e zgjidhjes së aktakuzës e shprehur në përqindje mbrenda periudhës së caktuar kohore.

Grafikoni: 3




Në këtë tabelë janë paraqitur Personat e mitur të dënuar në Gjykatat Themelore sipas viteve 2003/2018, gjithashtu edhe ndarja se sa janë të dënuar femra dhe sa meshkuj. Në vitin 2003 kemi 288 të dënuar 284 meshkuj dhe 4 femra, në vitin 2004 kemi numër më të madh të të dënuarve 338 nga 326 prej tyre meshkuj dhe 12 femra, viti 2008 kemi 719 të dënuar, 706 meshkuj dhe 13 femra ndërsa në vitin pasardhës 2009 kemi 686 të dënuar një ulje e lehtë, 673 meshkuj dhe 13 femra, viti 2015 kemi gjithsej 563 të dënuar, 548 meshkuj, 15 femra, vitin 2017 kemi numrin total të të dënuarve 766 prej tyre 726 meshkuj dhe 40 femra, viti 2018 kemi 713 të dënuar , 680 meshkuj dhe 33 femra, diferenca midis viteve 2017-2018 kemi një ulje të të dënuarve në vitin 2018 nga viti 2017 për -57 persona, meshkuj të dënuar kemi 46 meshkuj më pak se në vitin paraprak, dhe 7 femra më pakë të dënuar në vitin 2018 për dallim nga viti 2017.

Tabela:8

V i t i	Numri i të dënuarve	Gjinia e të dënuarve	
		Meshkuj	Femra
2003	288	284	4
2004	338	326	12
2005	229	224	5
2006	665	647	18
2007	648	637	11
2008	719	706	13
2009	686	673	13
2010	339	329	10
2011	375	366	9
2012	474	463	11
2013	786	769	17
2014	840	826	14
2015	563	548	15
2016	692	666	26
2017	766	726	40
2018	713	680	33
Diferenca : 2018 – 2017	-53	-46	-7

Në grafikonin numër 2 është paraqitur numri i personave të mitur të dënuar në Gjykatat Themelore sipas viteve 2003 / 2018. Ku shohim se në vitin 2018 kemi 713 të dënuar, viti 2017 kemi 766 të dënuar, 2016 kemi 692 të dënuar, 2015 kemi 563 të dënuar, në vitin 2014 është edhe numri më i madh i të dënuarve ku shifra mbërrin në 840 të dënuar, viti 2013 me 786 të dënuar, vitin 2012 kemi një rënje të madhe të numrit të të dënuarve me 474, edhe viti 2011 me 375 të dënuar, ndërsa viti 2010 dhe viti 2005 karakterizohet me numrin më të ulët të të dënuarve, viti 2010 me 339 të dënuar, kurse viti 2005 me vetëm 229 të dënuar shohim se numri më i vogël i të dënuarve është viti 2005, ndërsa numri më i madh i të dënuarve është viti 2014.

Grafikoni: 4



Ne vijim do të paraqesim Numrin e personave të mitur të dënuar në Gjykatat Themeloret sipas gjinisë dhe nacionalitetit të vitit 2018. Gjykata Themelore Gjilan me 150 të dënuar, ku 145 prej tyre meshkuj dhe 5 femra, 145 të nacionalitetit Shqiptarë dhe 5 të nacionalitetit Serb. Gjykata Themelore Prizren me 79 të dënuar, 74 meshkuj dhe 5 femra, kurse sa i përket nacionaliteteve 77 Shqiptarë dhe vetëm 2 të nacionalitetit Turk. Gjykata Themelore Pejë me 32 persona të dënuar 31 meshkuj dhe 1 femër, të gjithë Shqiptarë vetëm një Serb, Gjykata Themelore Prishtinë 250 të dënuar, 232 meshkuj, 18 femra të gjithë të nacionalitetit Shqiptarë për dallim të një personi i nacionalitetit Serb, etj.

Gjithsej numri i të dënuarve të mitur në vitin 2018 ka qenë 713 ku 680 prej tyre meshkuj dhe 33 femra ndërsa sa i përket dallimit në nacionalitete kemi të dënuar 698 Shqiptarë, 10 Serb, 2 Turq, 1 të tjerë.

Tabela: 9

Numri	Emri i Gjykatave	Numri i të dënuarve		Gjinia e të dënuarve		Nacionaliteti i të dënuarve				
		Nr.	%	Meshkuj	Femra	Shqiptar	Serb	Turq	Të huaj	Të tjerë
1	Gjykata Themelore Gjilan	150	21,0	145	5	145	5	-	-	-
2	Gjykata Themelore Prizren	79	11,1	74	5	77	-	2	-	-
3	Gjykata Themelore Pejë	32	4,5	31	1	31	1	-	-	-
4	Gjykata Themelore Gjakovë	36	5,0	36	-	36	-	-	-	-
5	Gjykata Themelore Prishtinë	250	35,1	232	18	248	1	-	1	-
6	Gjykata Themelore Ferizaj	133	18,7	129	4	131	1	-	1	-
7	Gjykata Themelore Mitrovicë	33	4,6	33	-	30	2	-	-	1
Gj i t h s e j:		713	100,0	680	33	698	10	2	2	1
%				95,4	4,6	97,9	1,4	0,3	0,3	0,1

Në vijim është paraqitur tabela 10 ku kemi të bëjmë me Personat e Dënuar të Mitur sipas disa lloje kryesore të Veprave Penale në vitin 2018 dhe 2017, si dhe do ta shohim krahasimin midis viteve të hulumtimit. Shohim se Vepra Penale Vrasje në Republikën e Kosovë gjatë vitit 2018 kemi 5 raste, ndërsa në vitin 2017 kemi 2 raste, 3 më pak se në vitin 2018, Bashkryerja në Veprën Penale Vrasje në vitin 2018 kemi 4 raste ndërsa në vitin 2017 5 raste, për Veprë Penale Kanosja kemi 13 persona të mitur të dënuar në vitin 2018 kemi 13 raste,

njetë sikurse edhe në vitin 2017 13 raste, gjithashtu shohim se të miturit janë kryerës edhe të Veprës Penale Bashkryerje e Veprës Penale Pjesmarrje në Rrahje, në vitin 2018 11 raste ndërsa në vitin 2017 13 raste, Veprën Penale Sulmi Seksual të miturit në tërë Republikën E Kosovës në vitin 2018 e kanë kryer 7 raste, ndërsa në vitin 2017 5 raste, shohim se kemi një shtim me dy raste nga viti në vit. Vepra Penale e paraprë sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës është edhe Bashkryerja e Veprës Penale Vjedhje e Rëndë, ku tregohet se është njëra ndër Veprat Penale e cila kryhet më së shumti nga të miturit, ku shohim se në vitin 2018 kemi 72 raste, ndërsa në vitin 2017 kemi 73 raste. Duke analizuar se në cilin vit të Miturit kanë kryer më shumë Vepra Penale dhe cilat lloje të tyre më shumë, shohim se nuk ka ndonjë dallim nga vitet është pothuajse numri identik me rritje dhe ulje normale midis vepra penale të caktuara, shembull: Sulmi Seksual viti 2017 kemi 5 raste, ndërsa vitin 2018 kemi 7 raste.

Tabela:10

VEPRA PENALE		NUMËRI I RASTEVE SIPAS VITEVE	
		2018	2017
Nr.1	VRASJE	5	2
Nr.2	BASHKRYERJA NË V.P VRASJE	4	5
Nr.3	KANOSJA	13	13
Nr.4	SULMI	13	14
Nr.5	BASHKRYERJA E V.P PEJSMARRJE NË RRAHJE	11	13
Nr.6	SULMI SEKSULA	7	5
Nr.7	POSEDIM I PAAUTORIZUAR I NARKOTIKEVE DHE SUBSTANCAVE PSIKOTROPIKE DHE ANALOGE	36	10
Nr.8	VJEDHE MË SHUM SE 50 EURO	33	38
Nr.9	BASHKRYERJE E V.P VJEDHJE E RËNDË	72	73


Personat e Dënuar sipas llojit të Veprave Penale në vitin 2016, kemi analizuar nëntë Vepra Penale të cilat kryhen më së shumti nga të miturit ku shohim se Vepra Penale e cila është kryer më së shumti në vitin 2016 nga të miturit është Vepra Penale Vjedhje më shumë se 50 euro me 26 raste për dallim nga vitet pasardhëse që ishte Vepra Penale Bashkryerje e Veprës Penale Vjedhje e Rëndë diku me mbi 70 raste sin ë vitin 2017 dhe at në vitin 2018, në vitin 2016 të miturit që kan kryer vrasje kanë qenë 7 persona ndërsa në Veprën Penale Bashkryerja në Veprën Penale Vrasje kemi 2 persona, 7 persona të mitur I kemi për veprën Penale Kanosja, ndërsa Vepra Penale Sulmi janë të dënuar 15 të mitur, duke analizuar vitet 2016, 2017, 2018 shohim se viti 2016 kemi më pak të mitur që kanë kryer Vepra Penale të tjera, ndërsa për fat të keq kemi në vitin 2016 kemi numrin më të madh të vrasjeve nga të miturit me 7 vrasje të kryera dhe 2 raste Bashkryerje në Veprën Penale Vrasje.

Tabela: 11

VEPRA PENALE		NUMËRI I RASTEVE SIPAS VITIT
		2016
Nr.1	VRASJE	7
Nr.2	BASHKRYERJA NË V.P VRASJE	2
Nr.3	KANOSJA	7
Nr.4	SULMI	15
Nr.5	BASHKRYERJA E V.P PEJSMARRJE NË RRAHJE	4
Nr.6	SULMI SEKSULA	6
Nr.7	POSEDIM I PAAUTORIZUAR I NARKOTIKEVE DHE SUBSTANCIVE PSIKOTROPIKE DHE ANALOGE	12
Nr.8	VJEDHE MË SHUM SE 50 EURO	26
Nr.9	BASHKRYERJE E V.P VJEDHJE E RËNDË	20

Në grafikonin me numër gjashtë kemi paraqitur ne formë të grafikoneve, Personat e mitur të dënuar sipas Gjykatave themeloret dhe masave të shqiptuara në vitin 2018, masa e mbikqyrjes së shtuar është shqiptuar me 56.1 %, Qortimi Gjygjësorë 15.0 %, punë në dobi të përgjithshme 5.3 %, masat disiplinore 4.5%, dënimet me burg prej 6-12 muaj 2.9 %, 2-6 muaj 3.2 %, dërgimi në qendrën disiplinore 0.6 %, dënimet me gjobë 1.4 %, masa e enteve 6.7 % etj.

Grafikoni: 5



Grafikoni i paraqitur ka të bëjë me efikasitetin e Gjykatës Themelore të Gjilanit, si dhe lëndët shqyrtimit mbrenda kësaj Gjykate gjatë vitit 2015-2018,

Se cilat lloje të aktgjykimeve më së shumti janë shqiptuar, ku shohim se me 51.5 % në vitin

2018 janë shqiptuar kundërvatje, rreth 13 % çështje penale të shkallës së parë, 11,5 % me civile të shkallës së parë, me procedurë paraprake me 3.2 %, jashtë kontestimore, 4.2 % ekzekutimin e lëndëve etj.

Shohim se dallimi midis vitetve 2015 2018 nuk dallon shumë është pothuajse i njëti ritëm i punës me të vetmin përjashtim tek kundërvatjet ku në vitin 2015 janë rreth 51.5 %, kurse në vitin 2018 me diku rreth 77.3%.

Grafikoni:6



PËRFUNDIMI

Në këtë punim shkencor synimi kryesorë ka qenë që të arrijmë në përfundim mbi faktorët dhe shkaqet e kryerjes së veprave penale nga të miturit duke analizuar se nga cila moshë të miturit fillojnë të shfaqin sjellje asocial dhe devijante, kemi bërë edhe elaborimin se cilat nacionalitet kryen më shumë vepra penal nga të miturit, gjithashtu do të analizojmë se kush kryen më së shumti Vepra Penale femrat apo meshkujt.

Gjithashtu analizimin e disa faktorëve që ndikojnë në kryerjen e veprave penale tek të miturit, duke i kushtuar rëndësi të veçantë faktorëve të jashtëm siç janë: Mas mediat, shtypi, literatura, filmi si dhe faktori më crucial që po ndikonë tek të miturit kohëve të fundi interneti, si dhe trajtimin e faktorëve të tjerë në parandalimin e kriminalitetit tek të miturit që janë organet shtetërore: Policia, Gjyqësori si dhe Qendra për punë Sociale.

Në këtë punim kemi shtjelluar edhe parimet bazë të Delikuencës së të Miturve, ku në detaje kemi elaboruar parimet e ligjshmërisë, parimi i pafajsisë, parimi e mbrotjes nga diskriminimi, parimin i humanizmit si dhe parimin e interesit me të lartë të fëmijës.

Kemi trajtuar edhe efikasitetin e organeve shtetërore në momentin e parë kur kanë të bëjnë me kriminalitetin nga të miturit, trajtimin e legjislacioneve vendas në këtë rastë Legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe legjislacionet e vendeve të tjera.

Kemi ofruar të dhëna statistikore se sa vepra penale kryhen nga të miturit prej periudhës kohore 2008-2018, se cilat lloje të sanksioneve shqiptohen më së shumti për të miturit, elaborimin e disa aktgjykimeve nga Gjykata themelore e Gjilanit - Departamenti për të mitur, si dhe elaborimin e aktgjykimit të marrur nga Gjykata e Apelit Prishtinë-Departamenti për të Mitur, analizimin e sanksioneve penale për të mitur dhe të masa preventive të cilat instucionet shtetërore i japin më së shumti rëndësi dhe cialt i zbatojnë.

Si përfundim nga puna e bërë mundemi të themi se Veprat Penale të kryer nga të miturit janë çdo ditë e më shumë në rritje, duke trajtuar legjislacionet e vendeve në rajonë konkretisht legjislacionet e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Republikës së Shqipërisë, vërejmë se legjislacioni i Republikës së Kosovës lidhur me trajtimin e delikuentëve të mitur është në një nivel më të lartë dhe me efikas sa i përket legjislacioneve teorike në krahasim me shtetet fqinje, por si të metë kryesorë në Republikën e Kosovës gjatë hulumtimit rreth këtij punimi dhe mbledhjes së të dhënave statistikore shohim se kemi ngecje në efikasitetin e organeve shtetërore pra kemi të meta në praktikën, pra kemi jashtëzakonisht qështje burokratike që

duhet ti eliminojmë si dhe të punojmë më shumë në efikasitetin e organeve shtetërore në praktikë, që kryesisht ose edhe viktimat nga e mitur të kenë më shumë qartësi se ku duhet të shkojnë kush mirren me ata dhe gjëra të tjera.

Literatura

I-Libra

- Ismail Zejneli Delikuenca e të Miturve, Tetovë, 2018
- Mihael Walter Delikuenca e të miturve(përkthim),Shkup,2011
- Ejup Sahiti&
- Ismail Zejneli E Drejta e Procedurës Penale, Shkup, 2017
- Ismet Salihu E Drejta Penale për të Mitur, Prishtinë, 2005
- Ismet Salihu E Drejta penale-pjesa e përgjithshme, Prishtinë,2016
- Ali. Dida- Patologjia Shoqërore e Të Miturve në Kosovë, Prishtinë,1996
- Vesel Latifi Kriminalistia e delikuencës së të miturve, Prishtinë,1982
- Vesel Latifi Politika Kriminale, Prishtinë, 2013
- Vlado Kambovski, &
- Ismail Zejneli, E Drejta Penale, Tetovë, 2018
- Bistra Netkova&
- Ismail Zejneli Trafikimi me njerëz, Tetovë, 2007
- Nijazi Zulfiu Didaktika, Prishtinë,1997
- Ragip Halili Kriminologjia, Prishtinë, 2016
- Vesel Latifi,&
- Haki Demolli Kriminalistika, Prishtinë, 2019

II- Burime tjera

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës – 2008
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal i Kosovës Nr. 06/L-074, 2019
- Ligji Për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-17, 2007
- Ligji Pë Mbrojtje nga Diskriminimi Nr. 05/L-021
- Kodi i Procedurës Penale Nr. 04/L-123

- Ligji Për Policinë Nr. 04/L-076
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur Nr. 06/L-006
- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur në R. Shqipërisë, Nr. 37/2017
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve
- Ligji për Procedurë Penale i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Ligji Mbi të Drejtat e Fëmijëve i RMV-së, Gazeta Zyrtare Nr.143, 2013
- Strategjia Shtetërore e RKS-së për Parandalimin e krimit- Plani i veprimit 2009 – 2012
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
- Gjykata Themelore Gjilan – Statistika 2013
- Direktivat e OKB – së për Parandalimin e Kriminalitetit – Direktivat e Riadit – Rezuluta 45/112, 1990
- Konventa Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijës, 1996
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- Rezuluta e Këshillit të Ministrave, 1978
- Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijëve – OKB, 1989
- Rregullat e OKB-së për Mbrojtjen e të Miturve-Rezuluta 45/113, 1990
- World Bank – 2005
- Isigurt.al – Platforma Kombëtare për Sigurinë e Fëmijëve në Internet